

INA ARAPI

TRAJTAT FONETIKE DHE KATEGORITË GRAMATIKORE TË PASKAJORES NË GJUHËN SHQIPE*

1. Trajatat fonetike të paskajores në gjuhën shqipe

1.1. Gjuha letrare shqipe e njësuar¹ nuk ka paskajore me funksione të plota sintaksore. Në vend të saj ajo përdor fjalitë e nënrenditura me lidhore dhe formën e pashtjelluar të tipit *për të bërë*, e cila është një paskajore me funksione sintaksore të kufizuara. Por paskajorja e tipit *me punue* është përdorur dhe vazhdon të përdoret edhe sot gjerësisht në dialektin gegë². Prandaj, kur flasim për paskajore në shqipen dhe për ndërkëmbimin e saj me lidhoren, ose format e pashtjelluara analitike, kemi gjithmonë parasysh gegërishten.

1.2. Çfarë kuptojmë me “formë e pashtjelluar”? E kemi përdorur këtë term me po atë kuptim që e përdor edhe “Gramatika e gjuhës së sotme shqipe”, I, Tiranë 2002, f. 285, e cila në bazë të mundësisë ose të pamundësisë për të ndryshuar sipas vetës e numrit i ndan format gramatikore të foljes në gjuhën shqipe në dy grupe të mëdha: në *forma të shjtjelluara* dhe në *forma të pashtjelluara*. Forma të pashtjelluara quhen ato forma gramatikore të një foljeje, të cilat nuk ndryshojnë as sipas numrit as sipas vetës. Gjatë evolucionit të saj historik shqipja ka krijuar disa forma të pashtjelluara analitike. Dy prej tyre kanë ardhur duke u përdorur gjithnjë e më tepër me ato funksione sintaksore që janë karakteristike për paskajoren e gjuhëve i. e. Është fjala për formën e pashtjelluar të tipit *me punue* dhe të tipit *për të punue / për të punuar*. E para, siç u theksua edhe më lart gjendet vetëm në gegërishten, ndërsa e dyta edhe në toskërishten, pra është e mbarë gjuhës dhe normative. Përveç kësaj, e

* Ky artikull është një variant i zgjeruar në gjuhën shqipe i kapitullit të parë të monografisë së autores “Der Gebrauch von Infinitiv und Konjunktiv im Altalbanischen mit Ausblick auf das Rumänische” (Hamburg 2010, f. 1-14).

¹ Gjuha letrare shqipe e njësuar (shqipja standarde), që u sanksionua në Kongresin e Drejtshkimit (1972), bazohet kryesisht në koinenë letrare toske. Që nga dokumenti i parë, “Meshari” i Gjon Buzukut (1555) e deri në këtë kohë, shqipja shkruhej në dy variante letrare kryesore të ndërtuara mbi baza dialektore (shih edhe shënimin 2).

² Të folmet e gjuhës shqipe grupohen në dy dialekte, që ndahen gjeografikisht nga lumi Shkumbin: në të djathtë të këtij lumi shtrihet dialekti verior ose gegërishtja, kurse në të majtë dialekti jugor ose toskërishtja. Veçoritë që i dallojnë këto dy dialekte përfshijnë kryesisht sistemin fonetik, por edhe atë gramatikor e leksikor.

para përdoret me të gjitha funksionet karakteristike të paskajores, ndërsa e dyta vetëm me disa nga këto funksione, prandaj edhe është karakterizuar si një paskajore me funksione sintaksore të kufizuara³. Çështja se cilat forma foljore të pashtjelluara të shqipes do të mund të përfshiheshin në sferën e funksioneve të paskajores ka qenë dhe vazhdon të jetë objekt diskutimesh, por vlera si paskajore e formës *me punue* është pranuar përfundimisht. Në fakt, që në gramatikën e parë shqipe të njohur deri më sot⁴, kjo formë konsiderohet si paskajore e mirëfilltë dhe përdoret rregullisht si ekuivalente e paskajores së italishtes. Ndërsa “Gramatika...” që përmendëm më lart, duke qenë gramatikë e gjuhës së sotme shqipe normative, e cila nuk e ka pranuar fare paskajoren si formë foljore, konsideron si formë të pashtjelluar pjesoren *larë*, përcjelloren *duke larë*, formën e pashtjelluar mohore *pa larë* si dhe format e pashtjelluara të tipit *për të larë* e *me të larë*.

1. 3. Edhe për përkatësinë kategoriale të pjesëve përbërëse të paskajores në rrafshin sinkronik dhe diakronik janë shprehur mendime të ndryshme. Në rrafshin *sinkronik* paskajorja *me punue* interpretohet zakonisht si e përbërë nga pjesëza *me* dhe nga pjesorja⁵. Duhet theksuar se pjesëza *me*, me origjinë parafjalore, i ka humbur prej kohësh funksionet e saj si parafjalë dhe është desemantizuar plotësisht. Për këtë arsye mendimi i atyre gjuhëtarëve, të cilët duke kërkuar domosdo edhe në shqipen një paskajore sintetike si atë të gjuhëve të tjera i.e. dhe duke njohur ende vlerën parafjalore të *me-së* i mohojnë shqipes formën e paskajores nuk është i mbështetur⁶. Ndërsa elementi i dytë që ndërton paskajoren, në planin sinkronik, përkon plotësisht me pjesoren dhe është pranuar si i tillë në të gjitha gramatikat përkrahëse të shqipes.

³ Shih *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe I*, Tiranë, 2002, f. 338.

⁴ Sipas Rexhep Ismajlit, “Gramatika e parë e gjuhës shqipe”, 1982, gramatika e parë shqipe e njohur deri më sot është ajo e hartuar nga Diego da Desio në vitin 1710.

⁵ Shih *Gramatika...*, Tiranë, 2002, f. 299.

⁶ Shih p.sh. Ilie Bacinschi, “L’infinitif et les moyens de son remplacement”, Bucarest 1946, f. 58, që thotë se “Pour ce qui est de l’albanais, il ne saurait pas être question d’un remplacement de l’inf., car ce qu’on s’est habitué à considérer comme un infinitif, à envisager les choses historiquement et non pas du point de vue de la grammaire pratique, à mon avis n’est nullement un infinitif. Dans les locutions guègues *me than*, *me ngran* avec le correspondant toskque : *do me thënë* - c’est-à-dire, *va sã zicã*, il ne s’agit d’autre chose que d’une périphrase moyennant le participe passé, pour servir à rendre l’idée de l’inf.” (Sa i takon shqipes nuk është fjala për zëvendësim të paskajores, sepse ajo që është bërë zakon të vështrohet si paskajore, po t’i shohësh gjërat historikisht dhe jo nga këndi i gramatikës praktike, sipas mendimit tim nuk është aspak paskajore. Në shprehjet *gege me thanë*, *me ngran* me korresponduesen toske *do me thënë*, nuk është fjala për asgjë tjetër veçse për një perifrazë me pjesoren e shkuar që shërben për të dhënë idenë e paskajores).

1. 4. Në planin *diakronik*, ky element i dytë është interpretuar herë si pjesore⁷, herë si paskajore dhe herë si pjesore e emëruar. Sigurisht, është e vështirë të argumentohet bindshëm se cili nga këto interpretime është i saktë. Sh. Demiraj në veprën “Gramatikë historike e gjuhës shqipe”, 1986, f. 955-957, mendon se interpretimi i elementit të dytë si pjesore nuk mund të pranohet, pasi pjesorja e së kryerës pjesore, siç ka qenë në fakt pjesorja e shqipes, duke pasur karakter mbiemëror, nuk mund të shoqërohej me parafjalë, veçse po të ishte e emëruar. Përveç kësaj pjesorja, si e tillë, ka pasur kuptim kryesisht pjesor, ndërsa forma e pashtjelluar analitike e tipit *me punue* ka kuptim kryesisht vepror, gjë që vërtetohet nga aftësia e saj për të marrë kundrina të drejta në rast se folja është kalimtare, p.sh. *me punue tokën*. Po kështu, i diskutueshëm është edhe interpretimi si paskajore, sepse një gjë e tillë do të presupozonte ekzistencën e një paskajoreje sintetike në gjuhën shqipe. Por edhe sikur të presupozohet që shqipja ka pasur dikur një paskajore sintetike, që e ka humbur prej kohësh, është e vështirë të pranohet që paskajorja dhe pjesorja në shqipen gjatë evoluimit të tyre të jenë përputhur formalisht. Foljet e prejardhura të tipit *geschehen* në gjermanishten, të cilat Pedersen i sjell si shembull për të vërtetuar këtë gjë, nuk mund të konsiderohen si një argument bindës, aq më shumë kur përputhja formale midis paskajores dhe pjesores së foljeve të këtij tipi në gjermanishten është plotësisht e shpjgueshme. Veç kësaj, pritej që kjo paskajore sintetike formalisht e përputhur me pjesoren të linte edhe ndonjë gjurmë tjetër, përveç asaj në format e pashtjelluara. Për këto arsye, mundësia që elementi i dytë përbërës i formës së pashtjelluar të tipit *me punue* të ketë qenë në zanafillë një paskajore, duket si e papranueshme, çka nuk kundërshton mendimin e Pedersenit, Joklit, Sandfeldit, La Pianës etj. lidhur me ekzistencën e një paskajoreje të hershme sintetike në shqipen.

Në këto kushte shumica e studiuesve pranojnë se elementi i dytë përbërës ka qenë në zanafillë një pjesore e emëruar, më saktë një emër prejpjesor (i paparanyjëzuar). Në një fazë relativisht të hershme të gjuhës shqipe, kur s'ishin krijuar ende emrat prejpjesorë të paranyjëzuar të tipit *të folurit*, emrat prejpjesorë të paparanyjëzuar të tipit *pasë-a*, *lypë-a* etj., ishin mjeti kryesor për të emërtuar veprime abstrakte. Pra, forma e pashtjelluar analitike e tipit *me bam* duhet të jetë përfutur me anë të gramatikalizimit të togut *parafjalë + emër prejpjesor i paparanyjëzuar*, ashtu sikurse forma e pashtjelluar mohore *pa punue* dhe përcjellorja *duke punue*. Format e pashtjelluara *me punue*, *pa punue* (tosk. *pa punuar*), *duke punue* (tosk. *duke punuar*), të ndërhuara mbi bazën e emrit prejpjesor të paparanyjëzuar, janë me siguri më të hershme se format e pashtjelluara *për të punue* (tosk. *për të*

⁷ Më saktë do të thoshim si formë e pjesores së shkuar, por meqë shqipja nuk ka pjesore të tashme, për mungesë kundërvënje e quajmë thjesht pjesore.

punuar) dhe *me të punue* (tosk. *me të punuar*) të krijuara në periudhën shkrimore të shqipes, kur emrat prejpjesorë ishin tashmë të paranyjzëuar. Sipas Sh. Demirajt “Këtë proces shndërrimi të shkallëshkallshëm e ka mundësuar shumë fakti i porsapërmendur që emri prejpjesor në gjuhën shqipe ka shërbyer për të emërtuar një veprim a gjendje. Kjo rrethanë ka bërë të mundur që i gjithë togu me kalimin e kohës të përforconte kuptimin foljor dhe, si rrjedhim, të merrte edhe tipare gramatikore foljore dhe në të njëjtën kohë të mënjanonte tiparet gramatikore të emrit të përdorur në një tog të lirë. Këtë proces shndërrimi të shkallëshkallshëm e ka mundësuar edhe fakti i njohur që në gjuhën shqipe pas disa parafjalësh të vjetra, sidomos pas atyre që ndërtohen me rasën kallëzore, emri është përdorur prej kohësh në trajtë të pashquar” (Sh. Demiraj, vep. e cit., f. 957). Në këto kushte pjesëza me origjinë parafjalore *me* nuk mund t'i jetë shtuar më vonë paskajores, pra nuk kemi të bëjmë me një parafjalëzim të paskajoreve sintetike, siç ka ndodhur p.sh. në gjuhët neolatine. Paskajorja e tipit *me punue* është formuar si e tillë bashkë me pjesëzën *me*. Bile kjo e fundit duhet të ketë luajtur një rol të rëndësishëm në formëzimin e paskajores, ashtu si parafjala *për* në krijimin e formës së pashtjelluar të tipit *për të punuar*.

Si përfundim, mund të thuhet se, pavarësisht nga mosha e saj, paskajorja e shqipes është në pajtim të plotë me paskajoret e gjuhëve të tjera i. e. për sa i përket rrugës së formimit nëpërmjet verbalizimit të një emri foljor në një rasë të caktuar, si edhe funksioneve sintaksore që kryen. Ajo ndryshon prej tyre nga mbaresat, sepse paskajorja e shqipes nuk ka mbaresa të veçanta, por ka të njëjtat mbaresa që ka edhe pjesorja. Siç thamë edhe më lart, paskajorja në shqipen e dokumentuar nuk ka prapashtesa të veçanta, por paraqitet me një formë që përkon me pjesoren e paraprirë nga pjesëza me origjinë parafjalore *me*. Pjesëza *me* ka pasur fillimisht një funksion të caktuar sintaksor, por me kohë ka humbur çdo vlerë semantike dhe funksionale si parafjalë dhe sot është shndërruar në një morfemë të pamungueshme të paskajores, ashtu si *të*-ja për lidhoren. Kështu në këtë pikë shqipja është e ngjashme me rumanishten dhe gjuhët gjermanike, të cilat kanë një paskajore që, në më të shumtat e përdorimeve të saj, pajiset gjithashtu me një pjesëz të pandryshueshme: khs. shq. *me punue* dhe rum. *a lucra*, angl. *to work*, gjerm. *zu arbeiten*. Por, në dallim nga këto gjuhë, ku paskajorja në disa përdorime mund edhe të mos pajiset me këtë pjesëz, në shqipen pjesëza *me* nuk mund të mungojë asnjëherë. Vetëm nëse janë disa paskajore të bashkërenditura pjesëza *me* mund të mos përsëritet. Sipas mendimit tonë, ky fakt e mbështet hipotezën se pjesëza *me* nuk është një shtesë e mëvonshme që lidhet me parafjalëzimin e paskajores, siç ka ndodhur p.sh. në gjuhët romane perëndimore, por ajo ka qenë pjesë përbërëse e paskajores që në krijimin e saj. Bashkohemi këtu me mendimin e shprehur se “Po të ishte se parafjala *me* i është shtuar më vonë një forme më të vjetër të një

paskajoreje sintetike për të konkretizuar dhe zgjeruar funksionet e saj sintaksore, do të pritej që paskajorja të përdorej edhe me parafjalë të tjera sipas funksionit që kryente, siç ndodh p.sh. në frengjishte, ku paskajorja përdoret edhe pa parafjalë, edhe me parafjalën karakteristike *de*, pothuajse të shndërruar në një pjesëz, edhe me parafjalë të tjera à, *pour*, *après*, *sans*, *avant* etj., sipas funksioneve sintaksore që kryen”⁸.

Pra, elementi i dytë përbërës i paskajores, siç thamë, nga struktura fonetike përkon plotësisht me pjesoren. Si pjesë përbërëse e paskajores pjesorja ka po ato mbaresa që ka edhe atëhere kur funksionon si pjesore e mirëfilltë. Domethënë se paskajorja ka po ato mbaresa që ka edhe pjesorja.

1. 5. Që nga dokumenti i parë i shqipes së shkruar (1555) paskajorja në këtë gjuhë ka pësuar ndryshime të rëndësishme fonetike. Kur themi këtë gjë kemi gjithmonë parasysh pjesën e dytë të paskajores, pikërisht atë që përkon me pjesoren, sepse pjesëza *me* gjatë gjithë kësaj kohe ka mbetur në fakt e pandryshuar. Më poshtë po përpiqemi të pasqyrojmë në vija të përgjithshme evolucionin fonetik të paskajores në gjuhën shqipe, duke e ndarë në dy periudha historike kryesore.

1. 5. 1. Struktura fonetike e paskajores në veprat e shkrimtarëve të vjetër veriorë⁹ (mesi i shek. XVI-mesi i shek. XVIII). Veçoria kryesore e strukturës fonetike të paskajores në këtë kohë është se ajo del rregullisht e pajisur me prapashtesë. Prapashtesat me të cilat formohet pjesorja¹⁰, respektivisht paskajorja në gjuhën shqipe të kësaj periudhe janë: *-m*, *-në*, *-un(ë)*, *-ë* dhe *-të*. Këto prapashtesa u shtohen temave të së tashmes ose temave të së kryerës së thjeshtë të foljeve.

⁸ S. Mansaku, *Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj* në “Studime filologjike”, 1982/1, f. 140.

⁹ Në këtë grup futen zakonisht autorët e mëposhtëm, të gjithë klerikë katolikë, veprat e të cilëve janë shkruar në dialektin gegë: **Gjon Buzuku** (“Meshari”, 1555); **Pjetër Budi** (“Dottrina Christiana”, 1618, “Rituale Romanum”, 1621, “Speculum Confessionis”, 1621); **Frang Bardhi** (“Dictionarum latino-epiroticum”, 1635); **Pjetër Bogdani** (“Cuneus prophetarum”, 1685); “Vendimet e Kuvendit të Arbënit” (Concilium Provinciale), 1706; **Gjon Kazazi** (“Breve Compendio della Dottrina Cristiana”, 1743). Për veprat do të përdorim respektivisht këto shkurtime: I, II për pjesën e parë, përkatësisht të dytë të “Mesharit” ose të “Cuneus prophetarum”, DC, RR, SC, KA, BC. Citimet sipas emrit të autorit, veprës dhe numrit të faqes.

¹⁰ Për trajtat e pjesores te Buzuku shih E. Lafe, *Trajtat e pjesores te Gjon Buzuku* në “Konferenca I Albanologjike”, 1965 dhe për trajtat e pjesores te Bogdani shih E. Paço, *Pjesorja në veprën e P. Bogdanit* në “Studime filologjike”, 1981/3, f. 75-86.

a. Prapashtesa -m. Me këtë prapashtesë e formojnë pjesoren, respektivisht paskajoren, foljet me temë në zanore dhe në diftongët *-uo*, *-ue*, *-ye*, *-ie*.¹¹ P.sh.: por ajo ditë tÿ të duhetë shkuom ùde e dashunë Tenëzonë, tue votë *me pām* meshë (Buzuku II, 61); Kush kā veshë *me ùdigluom*, ùdiglonjë (II, 111); blenë unctiona qi të madhe erë epnjinë, ato *me lyem* korpnë e Jezut (II, 241); i lutem ashtu ende, qi aspak të mos m aapë muo fajëtorit aqë vërtyt e forcë e fuqii *me j fëjyem* aqë ndierë nd anët e *me baam* ndoonjë kafshë, qi t ish kundra shintit urdhënë e ligjsë tii, - po të m apë aqë hiir e mëshërier, që të jeem i zoti gjithëherë *me baam* e *me vepëruom* ato kafshë, qi atii janë pëlqyem (Budi DC, 158); E pesta: plot me gjithë zemërë *me liiruom* e *me ndëjyem* gjith ata, qi nee na kanë fëjyem e baam ndoonjë të keqe oo dam e dhunë (DC, 103-104); e *me e voruem* si do ligja e krishtit (SC, 80); qi të mundnjë *me rrëfyem*, e me thanë mkatetë (SC, 12); sepelire: *me voruem* (Bardhi 149); tergovverfari: *me nkëthyem* shpallëtë ò shpinënë (173); tumultuare: *me bām* kallabë (177); e ka *me dëshëruem* regji bukurinë tande “et concupiscet Rex decorem tuum” (Bogdani II, 6); Oh të bāheshe e denja *me pām* e *me sherbyem* atë Virgjinë kaqë fattamirë “Oh se fossi fatta degna di vedere, e servire cotesta Vergine tanto fortunata” (II, 12); zu fill me atë gurrë lotsh *me lām* kambëtë “cominciò con quella fonte di lacrime à lavare li piedi” (II, 61); *me dām* grunin prej egjëret (Mulaku 134 / K. i Arbënit, 26); *me faruem* atë kujtimi të pa udhë (53); Kur të zānsh fill *me bām* ndonji pun (Kazazi BC 25, 306); *me u shëlbuom* (38); *me paguem* të dhjetën (Mulaku 134 / Kazazi 19); *me shperyem* (16).

Që në veprat e Budit e më pas edhe te autorët e tjerë pas tij fillojnë të shfaqen lëkundje në vendosjen e prapashtesës *-m* te pjesorja, përkatësisht te paskajorja. P.sh. në një rast te Budi gjejmë: *me lanë* e *me paguo* (SC, 94-95). Po kështu te K. i Arbënit: *me shī* ndë dhetë të bdekunit (Mulaku 134 / K. i Arbënit 81). Te Kazazi ky fenomen është pothuajse i zakonshëm: tue dashunë *me pa* a t’lulëxuem kishte (10).

b. Prapashtesa -në. Me këtë prapashtesë e formojnë pjesoren një grup i caktuar foljesh me temë në zanore, sidomos në zanore hundore, si: *dha-në*, *lanë*, *ngra-në*, *qe-në*, *tha-në*, *za-në*, *nxa-në*, *përza-në*¹².

P.sh.: muo *me më dhanë* shëndet ù mendjet e ù korpit (Buzuku II, 55); e aj tue mujtunë me shkuom pā *ùgranë* (II, 67); A anshtë me ligj nieriù *me lanë* grunë e vet për ùdonjë faj? (II, 383); e tue i msuom *me qenë* të mirë e të

¹¹ Një pjesë e shembujve që sillen këtu janë marrë nga Ragip Mulaku, *Sistemi foljor në gjuhën e shkrimtarëve të vjetër veriorë*, Prishtinë 1987, f. 126-136. Të tjerët janë shtuar nga autorja.

¹² Përveç këtyre në toskërisht kemi edhe *vë-në*, *shpë-në* (krahas *shpu-rë*), *shtë-në* (krahas *shti-rë*) dhe *bë-në* (në çamërishte dhe në të folmen e Gjirokastrës). Shih më hollësisht për këtë Demiraj (1986: 943).

feeshim të kërshenë (Budi DC, 93); E katërta: *me përzanë* ndë shtëpii shtekëtarëtë (DC, 102); E mbramanet e mëngjesit e ndë mjesëditët, kuur bie këmbona, qish urat kie zakon *me thanë?* (DC, 166); këtë kafshë, aspak s'duhetë *me lanë* (Budi SC, 39); kanë *me qenë* quojtunë të bijtë e tinë Zot (SC, 240); muscipula: krëfëca ò rasi *me zanë* zog e mī (Bardhi, 63); semefus: gjymisa *ngranë* (148); kulshedra e botë~së Arbënit, Gjeç ò Gjergj Kastrioti, *thanë* e thirrë Skanderbeg (197); për të vërtetë kish *me thanë* se kanë një Zot “certamente dirà, che hanno un Signore” (Bogdani I, 2); e dëshëron *me xanë* e me u bām i urtë “e defidera faper studiare, & attendere alla virtù” (I, 28); se kështu ka *me kjanë*¹³ ndëshkimi ma i randë e me forcë “che così farà la ammonizione, di più però autorità” (II, 75); *me përzanë* frymën (Mulaku 134 / K. i Arbënit, 15); as lye o faj a ndonji rudhë e të shtirunit duhet *me kjenë* (23); tue *zanë* me dëshir të fort (28); *me ngran* buk (50); qi do *me than* (Kazazi, 40); *me na dhanë* (8); *me ngran buk* (26); e kishte *me kjen* me hije e fort mir (32).

Siç shihet, te Kazazi gjysmëzanorja *-ë* e prapashtesës *-në* të pjesores në pjesën më të madhe të rasteve nuk shënohet. Kjo do të thotë që në këtë kohë ajo, duke qenë në pozicion fundor, shqiptohet dobët ose kishte rënë fare. Një rast të tillë kemi gjetur edhe te K. i Arbenit: *me ngran* buk (50). Te Bogdani kemi gjetur të paktën dy raste kur pjesorja e foljes *jam* del në trajtën *kjanunë*, pra jo me prapashtesën *-në*, por me trajtën e zgjeruar të saj *-nunë*: posikur *t'ish kjanunë* ma i madhi fajtuer mbë shekullit “come fosse stato il maggior peccatore del Mondo” (II, 25); ma pa pagëzim, o të ujit, o të gjakut, o të dëshirit *me kjanunë pagëzuem* “però senza battesimo ò dell'acqua, ò del sangue, ò col defiderio d'effere battezzati” (II, 162)¹⁴.

c. Prapashtesa *-unë*¹⁵. Zakonisht me këtë prapashtesë e ndërtojnë pjesoren foljet me temë në bashkëtingëllore, me përjashtim të likuideve. P.sh.: u denjuo atë *me grishunë* t̃bë shenjtet mishërier të tī (II, 77); e lutnë aj *me t̃betunë* me ta (Buzuku II, 163); e *me u mbajtunë* dëlir ũ së pāglanashit së shekullit (II, 257); Përse kanë *me u ũgritunë* Krishtëna të rëshim (II, 315); e aj nja i vetëmi e kaa puçtetnë e plotë dhanë prej Sinëzot... *me lidhunë* e me *xgjidhunë* ven~të Krishtit mëshëriershim (Budi DC, 29); e atë një të vetëminë bukur mirë *me e njoftunë* e *me e dijtunë* për zot e për krijuos e për të parë e jo tietër (DC, 59-60); posikundrëse thashë përsipëri, *me u ruojtunë* prej nci e *me u shtëmangunë* ma fort se murtajet së farmakuome (DC, 163); më votë *me lypunë*

¹³ *Kjanë* është variant fonetik dialektor i *qenë*.

¹⁴ Sipas E. Paços, *art. i cit.*, f. 79, prapashtesën *-nunë* në formimin e *pjesores* më shumë se të gjithë e përdor Gj. Kazazi.

¹⁵ Sipas mendimit më të përgjithshëm prapashtesa *-unë* është një trajtë e zgjeruar e prapashtesës së mëparshme *-në* me anë të tingullit *u*. Shih më gjerë për këtë Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 941-943.

ndë punë (Budi SC, 249); ma udob ashtë *me u shëndoshunë* (SC, 172); mellificare: *me përmialtunë* (Bardhi, 57); obedire: *me gjegjunë* (71); kam vetë *me mbetunë* pa frujt “sterilis ero” (Bogdani I, 14); ka *me më përgjegjunë* mue “respondebit mihi” (I, 16); Adami aso koheje kur kje krijuem nukë pat *me dekunë* “Adamo nello stato, qual fù creato non sarebbe morto” (I, 44); një regji yt ka *me ardhunë* “Ecco che il tuo Rè venirà” (II, 34); u çilnë qiejtë *me na derdhunë* shin (K. i Arbënit, 13); *me i gjegjunë* urdhënimit (39); kemi *me vikatunë* (68); *me ditun* gjith i silli (Kazazi, 16); *me u djegun* (37); kam *me gjetun* (45).

Te Budi paskajorja *me votë* që është ndërtuar mbi temën e së kryerës së thjeshtë *vajt-*, del rregullisht me prapashtesë zero, p.sh.: E Krishti i mëshëriershim me të mirët e me të shelbuomit... kanë *me votë* ndë regjëniitë qiellat me u gëzuom e me u ngushëlluom (DC, 142). Përveç kësaj, foljet *gjej*, *mund*, *vij*, me përjashtim të një rasti të vetëm kur del pa prapashtesë, *njef* dhe *gjell* me kuptimin “jetoj”, të cilat duhet të merrnin në fakt prapashtesën *-unë / -ë*, e formojnë paskajoren me prapashtesën *-m* ashtu si foljet e grupit të parë, p.sh.: n teeje *me gjetm* ndëjesë (222'); se kaa *me ardhm* me dhanë feenë (214'); S mund me kallëzuom / aqë t idhuna mundime, / as *me njefm* (208); kini *me gjellm* mirë e me qenë ndë të beekuomi¹⁶tem (75-76).

Te Bogdani kemi gjetur pak raste kur paskajorja e foljes *kam* del pa prapashtesën *-unë*: Abrami nukë kish *me pasë thanë* atyne “detto altrimenti Abramo non haverebbe à quelle tre persone” (I, 12); përse *me i pasë rām* patërshanë *kish me pasë mbytunë* “perche se li fosse, stato tirato una lanciata l’haveria vccifo” (I, 44-45); se aj mundën me bam me u djergunë prej qiellshit per ta ndihmuem, *me pasë dashunë*, shumë legjiona engjijsh “che egli havria potuto far scendere dal Cielo à sua diffefa, se hauesse voluto, molte leggioni d’Angioli” (II, 100).

Te Kazazi, ashtu si prapashtesa *-në* më përpara, edhe prapashtesa *-unë* del pa tingullin fundor *-ë*. Arsyet e kësaj rënieje në të dyja rastet duhet të jenë të njëjta. Përveç kësaj ka edhe një rast kur paskajorja del fare pa prapashtesë: e të mos e lëshoim vetvet¹⁶hen me lak¹⁶muom e *me ndiek* kafsh të pāudha (BC 41, 448-490). Më vonë një prirje e tillë do të përhapet gjithmonë e më tepër dhe vazhdon të jetë dominuese edhe në ditët tona¹⁶.

¹⁶ Paço, *art. i cit.*, f. 77 konstaton të njëjtën dukuri edhe te pjesorja. Sipas saj “Përdorimi i këtyre pjesoreve pa prapashtesën *-unë* ishte përhapur më tepër në gjuhën e folur e më vonë dhe në gjuhën e shkruar pas Bogdanit e Kazazit”. Sipas L. Mulakut (në veprën “Govor Albanaca Bajgorske Šalje”, 1968, f. 274) ajo i takon gjysmës së dytë të shek XVIII dhe dhjetëvjetëshit të parë të shek. XIX”.

d. Prapashtesa -ë¹⁷. Me këtë prapashtesë e formojnë pjesoren përgjithësisht foljet që dalin me temë në likuidet *l, ll, r, rr*. P.sh.: ashtu atë ditë kanë *me u bdjerrë* gjithë të kujtuometë e tyne (Buzuku II, 59); u baftë i denjë aj me mujtunë *me shkelë* t̃bë mishërier të Bagmit tit, e aj *me marë* për shëndet të shelbuomitë tat (71); ti të denjonesh atë *me përcjellë* t̃bë mishërier të Bagmit shenjhtë tit (II, 73); si për ndimët të atii populli ashtu ende *me nxierrë* pakëzë gjumënë e disave (Budi DC, 2); Këtu zaamë fiill *me folë* e me kallëzuom gjaakafshë urdhënimeshit së shintesë kishë katolike (DC, 71); veçëse *me thirrë* malet e sukavet me një të madh vaaj e gjamë (DC, 136); *me vjellë* aty shintinë sakrament, aqij nsë krepulluomi e venet së paakorë (SC, 94); s'duhetë *me u marë* sikur penduoshim e ndy zemëre (SC, 168); profundere: *me folë* nkot (Bardhi, 111); respirare: *me marrë* frymë (132); Qish të baish, bane urtshim, e shuko si k̃a *me të dalë* (207); kroenatë *me mos u shterrë* “li Fonti non seccarfi” (Bogdani I, 2); desh ende *me i falë* vetëvetëhenë “volle anche donarli fe stefo” (II, 1); *me mbiellë* faren’ e vet “come ṽci il feminare a feminare” (II, 64); s'ka *me dalë* plaga prej shtëpisë tyne (K. i Arbënit, 35); *me ndalë* pritesënë damatore (48); ka zakon *me e ndjellë* (28); *me nxjerrë* këta lisa prej ranxet (25).

Te Kazazi foljet me temë më likuide nuk diferencohen nga foljet me temë më bashkëtingëllore dhe marrin të gjitha prapashtesën *-un*, ndërsa prapashtesa *-ë* nuk përdoret fare, p.sh.: *me na nxjerrun...* mundimeshit ferrit (8); do *me marrun* (13); *me i dëlirun* (36); *me dalun* andy (37). Sipas E. Paço, art. i cit., f. 79, konfondimi i prapashtesave *-ë* dhe *-unë* vihet re më tepër te pjesorja sidomos te Buzuku dhe në një mënyrë më të kufizuar te Bogdani, por edhe te DC e Budit foljet *dëlir, gjell, nder* si edhe ndonjë tjetër dalin pothuajse gjithmonë me prapashtesën *-unë* dhe jo *-ë*, si p.sh.: n ditet së gjyqit kanë *me u ngjaallunë...* gjithë të vdekunitë (32); ashtu sikundrëse do ligja e meriton me qenë *nderunë* (42); qi fort e ndihmojnë nieeriinë *me gjellunë* (93-94); ndeevonë dera e ferrit mb atë ças kaa *me u mbërshelunë* e *me mos u nçelë* maa kuurraaj (142); po *me u dëliirunë* nci maa çpejt, qi të mundënj (163).

Një rast i tillë na ka rënë në sy edhe te K. i Arbënit: *pështjellunë* me diekëqi të zakonit të ndyshimi (48). Në periudhat e mëvonshme lëkundjet në vendosjen e prapashtesave përkatëse do të vinë vazhdimisht duke u shtuar.

e. Prapashtesa t̃ë¹⁸. Këtë formant për formimin e pjesores, përkatësisht të paskajores e ndeshim vetëm te Buzuku: as *me p̃të* s i dhae (II, 69); Të sëmënë nukë vojte *me e p̃të* (II, 69); *me klenë l̃atë* (II, 73); Po qish votëtë *me p̃të?* profetënë? (II, 87); *me shp̃të* punëtorë ndë vëneshhtë të t̃i (II, 107); e në do kush *me u p̃r̃p̃të* (II, 109). Interesant është fakti që ky autor për të

¹⁷ Një variant i reduktuar dhe më i ri i prapashtesës *-në*.

¹⁸ Më hollësisht për këtë prapashtesë shih Sh. Demiraj, *vep. cit.*, f. 942-944.

ndërtuar pjesoren e disa foljeve përdor herë prapashtesën *-të*, herë prapashtesën *-m* dhe herë atë *-në*. Kështu ai përdor paralelisht *patë*, *pam* (327), *panë* (363); *latë*, *lam* (219), *lanë* (219); *pitë*, *pim* (217), *pinë* (321) etj. Pra, te Buzuku të tria këto prapashtesa në mjaft raste shkëmbehen njëra me tjetrën pa ndonjë dallim kuptimor ose funksional.¹⁹

Prapashtesa *-të* pas Buzukut nuk shfaqet më, por gjurmë të saj gjejmë mjaft në shqipen e sotme letrare, siç janë pjesoret e ndajfoljëzuara të tipit *tha-të*, *ra-të*, *ngroh-të*, *ftoh-të*, *nxeh-të* etj.

f. Te Kazazi ndeshim edhe disa trajta pjesoresh me prapashtesën *-nun*, si: ënsht *zanun* (31), na i ka *lanun* (121) krahas *me e lan* (41) dhe *jen...zan* (43). Me sa duket në këtë rast kemi të bëjmë me një shfaqje të mbikarakterizimit gramatikor, që është përfutur duke i shtuar prapashtesën *-un* trajtës së pjesores më *-në*.

1. 5. 2. Struktura fonetike e paskajores në shkrime të ndryshme nga gjysma e dytë e shek. XVIII deri në vitin 1872. Struktura fonetike e paskajores në këtë periudhë karakterizohet nga prirja gjithnjë në rritje për t'i humbur prapashtesat.

a. Foljet me temë në zanore dhe në diftongët *-ue*, *-ye*, *-ie* tek autorët më të hershëm e ndërtojnë pjesoren, përkatësisht paskajoren me prapashtesën *-m*, ndërsa tek autorët më të vonë pa prapashtesë, ose brenda të njëjtit autor herë kështu e herë ashtu. P.sh.: Ky asnjë faj s'ka *bam* (A. i Elbasanit²⁰, 120); sytë e mi çelë nesër ke për ti *pam mbuluam* (76); e ai ju ka për të ju *dëftyam*²¹ vend të madh (72); ti j(e) qi më ke *krijuam* (82); e s'u largove tye *bâam* të gjitha (Dh. Todhri²², 171); të kesh *me qeruam* shpirtënat tonë; kam *me shkûum*²³ me

¹⁹ Sipas R. Mulakut, *vep. cit.*, f. 132, një rast i pjesores me prapashtesën *-të* del edhe në veprën e Bogdanit: ... u tha se ajo dorë Djemënish nuk mundej me u duem jashtë, veçse *me vratë* (II, 74). Në fakt kemi të bëjmë këtu me një lexim të gabuar nga ana e autorit: *vratë* nuk është folje, por emri *uratë*, pra duhet lexuar: me *uratë*.

²⁰ Jemi bazuar në botimin e këtij dorëshkrimi nga I. Zamputi, *Dorëshkrimi i Anonimit t'Elbasanit - transliterim, transkriptim dhe koment*, në "Buletin i Institutit të Shkencave", 1951, nr. 3-4, f. 64-131. E diskutueshme është koha të cilës i përket dorëshkrimi në fjalë. Sipas Dh. S. Shuteriqit, *Histori e letërsisë shqipe për shkollat e mesme*, Tiranë, 1955, f. 30, ai i përket pjesës II të shek. XVIII, ndërsa sipas Z. Kodrës, *Letërsia e vjetër shqipe dhe arbëreshe*, Tiranë, 1952, f. 57, mesit të shek. XVIII. Ne anojmë më tepër nga mendimi i këtij të fundit.

²¹ Për hapjen e diftongëve *-ue*, *-ye* në *-ua*, *-ya* shih E. Çabej, *Diftongje e grupe zanoresh*, në "Studime gjuhësore", VI, Prishtinë 1977, f. 120-126.

²² Jemi bazuar në botimin e Dh. S. Shuteriqit, *Shkrime të Dhaskal Todhërit dhe të pasardhësve të tij elbasanas, shoqëruar me fjalorin e shkrimeve të Todhërit*, në "Buletin

vërtetënit tate (176); e ka *me ndjyem* fajet e mia (174); Oh ç'kunor e lumnuoshme kena *me bâ* ty ktu n'dhee (Z. Guagliata²⁴, 7); e mos na le *me ra* n't'keq (53); s'munet as *me hi* n'kish, as m'u shtë n'vorrin shëit (161); *m'u rfyë* e *m'u kungue* nopak një her n'viet (149); Bier se asht koha *me raa* (Z. Jubani²⁵, 43); *Me pa* larg, hyp maje kodërs (46); Jam nisun *me shkue* ndër shok (35); na duhet *me ndie* në mos e - pàst zán t' búkúr (36); S'ke *me ngamë* Zotin e Perendinë tand (K. Kristoforidhi²⁶, 5); sepse ata kanë *me u ngimë* (6); s'keni *me hymë* ndë mbëretënit të qilvet (7); a njanit ka *me i shkuem* mbrapa, edhe tietërit ka *me i këthyem* shpinënë (11).

Te A. i Elbasanit prapashtesa *-m* është bashkuar për analogji edhe me disa folje me temë më bashkëtingëllore për të formuar emra prejpjesorë: nuku kërktoj *të dashmitë* tem po *të dashmit* e *çuamit* prindit im (89); pas së *gritmit* të tij (128).

Te Dh. Todhri krahas prapashtesës *-m* ndeshim për herë të parë edhe prapashtesën *-mun*, që duhet të jetë formuar nga bashkimi i prapashtesave *-m* dhe *-un*²⁷: kam *me lavdumun* emënin tat më jetët (176); mos ki *me largumun* mallëngjimin tat prej nesh (176); qi të ket *me i mallëngjymun* zoti (168); mos kij *me kthyemun* faqen tate prej meje (170). Raporti midis të dyja prapashtesave është afërsisht 3,5:1. Nëqoftëse te: tye *pëgaah* shtatënat e tyne me shoq shoqt (177) nuk ka gabim shtypi [khs. si muar bukë me shenjtet, e të pastra e *të pa pugâmet* duart e tii (171)], atëhere kemi të bëjmë me një rast pjesoreje pa prapashtesë. Ashtu si te A. i Elbasanit edhe këtu prapashtesa *-m* është bashkuar për analogji edhe me disa folje me temë më bashkëtingëllore për të formuar mbiemra, përkatësisht emra prejpjesorë: *e perëndi ruajtmet* mbretnet tonë (166); jetën *e pasosme* (167) [khs. *së pa sosunës* jete (172)]; *të ndenjmit* më të djathët (171).

i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore”, 1959, nr. 1, f. 165-197. Përsa i përket datimit të këtyre shkrimeve, thuhet këtu se ato duhen vështruar si të shekullit XVIII.

²³ Monoftongimi i *-ue* në *-u* vihet re edhe në raste të tjera. Shih për këtë E. Çabej, *vep. cit.*, f. 123.

²⁴ “Dottrina e Kershten Cardinallit Bellarmino t'Shoqnië Jesus kthiellun n'shqyp prei P. Zefit Guagliata t'shoqnië Evet”, N'Rom të shtampuemin t'sheitit Kuven De Propaganda Fide, 1856, ribotim. Botimi i parë është bërë në vitin 1845.

²⁵ Giuseppe Jubany, *Raccolta di canti popolari e rapsodie di poemi albanesi*, Trieste 1871.

²⁶ KATER UNGILAT' E ZOTIT EËË SEL'BUESIT T'UNE IESU - KRIËTIT, EËË PUNET' E APOSTUYVET, KEËUEM PREI GREKIËTESE VIETER ŠKIP NDE GUHE GEGENIËTE PREI KONSTANTINIT KRISTOFORIDIT, ELBASANASIT, KONSTANTINOPOLO 1872.

²⁷ Shih edhe Pekmezi (1908: 194).

Te Guagliata prapashtesa *-m* ruhet disa herë edhe te pjesorja: Em vlla s'ka *bam* ket fai (145); kur kië *pàme* prei shëitnushmes Mrii (69); Jesu Krishti kië *vùm* n'kryq n'gjasht sahat (29). Bile, brendapërbrenda së njëjtës fjali gjejmë herë pjesoren me *-m*, herë atë pa prapashtesë: ne ty *shâim* tui *gjimue* e tui *qa* ne ket shekul plot me lot (77); me *kerkue* si kena *fyem* Tenzon (207); tui *ba* mkat kam *fyem* ty (211). Raporti midis prapashtesës *-m* dhe asaj zero është 1:3. Këtu nuk janë llogaritur mbiemrat e emrat prejpjesorë, të cilët dalin që të gjithë me prapashtesën *-m*. Për analogji *-m*-ja i është vënë gabimisht edhe mbiemrit *i pasosm*. Në një rast del përsëri prapashtesa *-n* në vend të *-m*: *bân me hîn* n'shëiten Kish katolik (177).

Te Jubani prapashtesa *-m* ruhet në një rast te pjesorja, në dy raste te paskajorja dhe në dy raste te mbiemri prejpjesor: e tui *kùituém*, se shka me *báa*; se shká *me gjikuém*; T'párve tui dôt i - ndigjoni, / Per n'daçi mir *mé - ú - dáame* (80); Nji vorr gòdit me rrasa *t'púnuéme* (38); Jet i - *shituem* prei rféieiet (43). Pak folje me temë në zanore e formojnë pjesoren, përkatësisht paskajoren, herë pa prapashtesë e herë me prapashtesën e përbërë *-mun*: Kurr nuk ma bane nje ndeer, si - kur te kam pas *bamun* une ty (34) [khs. tui ba zhurm (35)]; Per *me pàmún* qàfàlit (70); Kët Bina fort të mir / Desht *mè damún* copa, copa (84) [khs. kam *daa* nji cop buk (31)]; Me zalina *vumun* çatall (104) [khs. I - paç *vúu* shulin dèrs (36)].

Si përfundim mund të thuhet se procesi i rënies së kësaj prapashtese ka ardhur vazhdimisht duke u thelluar dhe sot në të folmet e gegërishtes verilindore e perëndimore për këto tema foljesh përdoren kryesisht pjesore, përkatësisht paskajore me prapashtesë zero.

b. Një grup i caktuar foljesh me temë në zanore hundore vazhdojnë ta ndërtojnë pjesoren me prapashtesën *-n(ë)*. P.sh.: Po *me mos qenë* i perëndisë s'mun të bante gja kurrë (A. i Elbasanit, 130); tye *thanë* këto fjalë (78); E gjithë kush ka *lanë* shtëpinë (130); dhe kanë *me qënë* mallëngjimët e madhit perëndi (Dh. Todhri, 172); kam ne shum *për t'ju thënë* juve (177); dhe mos kij *me na lëanë* ne qi shpreejmë më tyij (174); Duroi *me ken* yti (Z. Guagliata, 83); Nuk është borg *me than* mkatet veniàl, por është *mâ mir me i than* (217); Jeta e shpirtit merret shokut tu' i *dhan* shkanul (137); Flët si *me kën* nji fmi (Jubani, 43); bjëri mrapa edhe prei vedi *me zàan* (46); *me e lan* Nanen tànde vetun (104); Iesui filloi *me i thanë* gjindëjesë për Gionninë (Kristoforidhi, 20); filluenë me shkoqunë kalleza, e *me ngranë* (21); edhe keni *me i përzanë* prei qyteti mbë qytet (48).

Paralelisht te Guagliata për analogji me foljet me temë në bashkëtingëllore, përdoret edhe prapashtesa *-nun*: Masi t'kemi *thanun* rfyemin (215); Zotyn a kishte *dhanun* Adàmmit vetum kta dhumtii? (261); e n'barë persë na ka *lanun* ket sakrifiz (187).

Edhe te Jubani gjejmë në pak raste prapashtesën e përbërë *-nun*: Rrena rren ke dò, qi asht *-i - zanun* bès “chi è di buona fede” (36); *Tui dhanun* gjiit dialit (108). Me rëndësi është gjithashtu fakti që në shpjegimet gramatikore që jep, paskajoren e foljes *jam* ai e shënon “Me-këenun (Essere)”, ndërsa pjesoren “këen”.

Po kështu te Kristoforidhi pjesorja e foljes *jam* merr zakonisht po këtë prapashtesë: gjithë korpi yt ka *me kenun'* i ndritshim (10); erësina sa e madhe ka *me kenune?* (10) etj.

c. Foljet me temë në bashkëtingëllore te autorët më të hershëm e ndërtojnë pjesoren, përkatësisht paskajoren me *-unë*, ndërsa te ata më të vonë me prapashtesën zero, ose herë ashtu e herë kështu. P.sh.: kij durim si kam *për të pasun u* (A. i Elbasanit, 76); nesër kanë *për të ikun* të gjithë (77); të qenkshe këtu, vëllai im s'kishte *vdekun* (95); qi kushdo të besojë këtë të mos keetë *me humbun*, po të keet *me pasun* jetën e pa sosun (Dh. Todhri, 171); të kemi *me veshun* njerinë e ri (175); t'cillt tnoin *me prish* feen e *me flligj* veset (Z. Guagliata, 7); ai ka *me dek* n'mkat mortar (61); do t'munohet *me muit* diëllin (147); per *me kap* e *me myt* Jesu Krishtin (159); Mrama duè *me ardh* tù tine *me buiint* (Jubani, 45); shka s'kam *muit* vet *me ia mrrit* me meet e *-mia* (46); Për *me ardh* *me deek* ne Shkodër (90); per *me u mbushunë* qish ashtë thanë prei Zotit (Kristoforidhi, 3); edhe ka *me mbeledhunë* grunin' e vet ndë grunart, por kashtenë ka *me e diegunë* me ziarm të pa-shuem (4); Unë kam *me ardhunë*, e kam *me e shendoshunë* (13).

Te Dh. Todhri vetëm në një rast paskajorja del pa prapashtesën *-un*: dhe mos kiiij *me na braktis* neve (167).

Guagliata përdor prapashtesën *-un* vetëm për pjesoren dhe për të gjithë mbiemrat prejpjesorë, por jo për paskajoren: Jesu Krishti kie *hiekun* prei kryqiet (29); qi ai t'jet *njoftun* prei gjith shëkulit (55); me vesh *t' sdëshunit* (255).

Sipas vëzhgimeve të mia sot në gegërishten verilindore kjo prapashtesë ruhet zakonisht te mbiemrat prejpjesorë, ndërsa vetë pjesoret dalin pothuajse gjithmonë me prapashtesën zero.

d. Foljet me temë në likuide e ndërtojnë pjesoren, përkatësisht paskajoren me prapashtesë zero, por ka dhe raste kur ruhet prapashtesa e vjetër *-ë*: U shkrua m emnë qi kishte *për të marrë* gruan e tij (A. i Elbasanit, 35); syt e mi *çelë* nesër ke për ti pam mbuluam (76); ai qi të shpall Krishnë *nxjerrë* të jetë prej Sinagoiet (128); e nuk ka *me folë* prej vetiu (Dh. Todhri, 177); ti je perëndi i pa rrëfyem... i pa dukun, e i pa *marrë* me mend (171); mos *me marr* jetën e shokut (Z. Guagliata, 133); perse Zotyn s'ka *me fal* mkatet e tia (61); i jep gairet *me dal* zot fees (181); e *me bierr* jeten me i mâit (49); *Me -i - siell* marre t'madhe (Jubani, 56); *xiërr* e - kàm prei rëzikut (43); Doishin Turqit *me ia marre* (110); Edhe ka *me pielë* bir, edhe ke *me ia thirë* emeninë Iesu

(Kristoforidhi, 2); i bir' i nieriut ka urdhënë mbi dhet *me falë* faje (15); dielli ka *me u erunë* (50).

Te A. i Elbasanit në një rast -ë-ja nuk është shënuar: kuja të ju a lii fajet ja kam *val* u (85). Por prapashtesa -ë ruhet rregullisht te mbiemrat prejpjesorë. Në pak raste, te këta mbiemra, për analogji me ata që mbarojnë më bashkëtingëllore, është shtrirë edhe prapashtesa -un: e dera ishte *mbullun* (86); mbë hurdhë të deshvet...pesë *të çeluna* kishte (115); E *të shkelunat* e Kishës u çanë mbë du (122).

Po kështu te Dh. Todhri, Guagliata e Jubani prapashtesën -un e gjejmë shumë rrallë te paskajorja e më tepër te pjesorja dhe mbiemrat a emrat prejpjesorë: perëndia im kam *me tu shpallun* tyj (Dh. Todhri, 176); sàshtë *i stalun* (= i denjë) asnji prej acish (169); tui ba mkat kam *bierrun* perrisin (Guagliata, 211); Per ç'sebët ne niësen asht *falun* munimi sosm? (225); *dhanun* prei sheitit at pap Paal i pesti (11); bân ktë per at t'vëtnit meritim te pâmkatit *t'zanunit* tan (228); Lumi ai qi bân mir, sè kùrr s'asht *i - biërrun* as n'kèt jet, as n'jët tiëter (Jubani, 39); *Më marrun* qith Spahit (68); Ku káa *gulún* Bàyràkt (72).

Edhe te Kristoforidhi prapashtesa -unë përdoret relativisht shpesh te paskajorja, te pjesorja dhe te emri a mbiemri prejpjesor: sepse ata duenë *me u falunë* tue ndeitunë ndëpër synagogat (9); Ç'do bimë qi s'e ka mbiellë Ati em qiellori ka *me u shkulunë* (30); dërgoi shërbëtorët' e vet *me thirun'* ata qi qenë *thirunë* ndë darsmat (44).

2. Kategoritë gramatikore të paskajores në gjuhën shqipe

Paskajorja në gjuhën shqipe dallon formalisht vetëm dy kategori gramatikore: të diatezës dhe të kohës.

2.1. Kategoria gramatikore e diatezës. Paskajorja në gjuhën shqipe mund të ketë formë veprorë ose joveprorë.²⁸ Diateza është e vetmja kategori gramatikore e paskajores, e cila dallohet në mënyrë të qartë që në dokumentin e parë të shqipes së shkruar. Meqenëse në këtë gjuhë paskajorja nuk merr mbaresa vetore, për të ndërtuar formën joveprorë të saj ajo mund të shfrytëzojë vetëm dy prej tre mjeteve që zotëron shqipja për shprehjen e formave joveprorë në përgjithësi: pjesëzën me origjinë përemërore *u* që vendoset midis pjesëzës *me* dhe pjesores, si dhe foljes ndihmëse *jam*.

²⁸ Termat *formë veprorë* dhe *formë joveprorë* përdoren këtu me atë kuptim që janë përdorur edhe në *Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*, II, Tiranë, 1976 (respektivisht *Gramatika e gjuhës shqipe*, Vëllimi I, *Morfologjia*, Tiranë, 2002). Këto gramatika dallojnë katër diateza në gjuhën shqipe: veprorë, pësore, vetvetore dhe mesore. Forma joveprorë e foljes në gjuhën shqipe është e përbashkët për diatezat pësore, mesore dhe vetvetore.

S. Mansaku, i cili është marrë sidomos me shqyrtimin e “Mesharit” të Gj. Buzukut, në artikujt e përmendur arrin në këto përfundime kryesore lidhur me kategorinë e diatezës te paskajorja:

- paskajorja joveprore përdoret shumë më rrallë se sa paskajorja veprorë, por kjo ka të bëjë me natyrën e ndërtimeve joveprore në përgjithësi

- nga pikëpamja funksionale paskajorja joveprore nuk ka kufizime në përdorim, ajo përdoret në të gjitha funksionet ku përdoret paskajorja veprorë, madje edhe kur vjen pas një emri ose mbiemri

- në të gjitha rastet kur paskajorja bën pjesë në një formë perifrastike (e ardhmja *kam me punue* ose e ardhmja e së shkuarës *kisha me punue* etj.), si edhe në ndërtimet me folje modale ose aspektive, diateza joveprore shprehet nga paskajorja me pjesëzën *u* ose me foljen *jam*, ndryshe nga treguesit e tjerë gramatikorë (veta, koha), që përgjithësisht shprehen nga foljet ndihmëse, modale ose aspektive. Forma joveprore e foljes modale që drejton një paskajore nuk luan asnjë rol në përcaktimin e diatezës së një ndërtimi modal, prandaj ka edhe raste kur si folja modale, ashtu edhe paskajorja përkatëse janë në formë joveprore.²⁹

Përfundimi kryesor është se “Në gjuhën shqipe kategoria e diatezës te paskajorja e tipit *me punue* paraqitet me tipare kuptimore dhe formalogramatikore të përcaktuara mirë që në librin e parë shqip”.³⁰

P. Bogdani, i cili e shkroi veprën e tij rreth 130 vjet më vonë e përdor paskajoren joveprore në këto përpjesëtime: nga rreth 2400 ndërtime me paskajore afërsisht 1/5 janë ndërtime me paskajore joveprore (465). Më konkretisht, më shumë se gjysma e ndërtimeve me *paskajore të pavarur* (21), rreth 1/5 e ndërtimeve *kam + paskajore* (186), më shumë se 1/4 e ndërtimeve *mund (mundem) + paskajore* (60), rreth 1/3 e ndërtimeve *duhet + paskajore* (45), 1/6 e ndërtimeve *folje aspektive + paskajore* (17), 100 nga paskajoret me funksione fthillëzuese dhe gati 1/5 e ndërtimeve me paskajore me funksione rrethanore (16) kanë në përbërjen e tyre një paskajore joveprore. Mbi bazën e këtyre të dhënave mendojmë se të paktën te Bogdani nuk mund të flitet për një përdorim të rrallë të paskajores joveprore. Ajo që përdoret shumë rrallë është paskajorja e varur me funksione rrethanore.

Ja disa shembuj me paskajore joveprore në gjuhën shqipe të vjetër: E *u desh me u gëzuom* e më marë kã plot, përse kÿ uit vëllã kle vdekunë, e u ùgjãll; kle bdjerë, e u gjet (Buzuku II, 151); E *zunë me u kujtuom* shkruositë e farizejtë, tue thashunë: kush anshtë kÿ qi bjastemon? (II, 271); tue kujtuom ato mundime gjith aqë fort të mëniishime e t idhuna, ndër të ciat janë gjukuom *me u diegunë* e *me u munduom* për gjithë jetë~të jetësë (Budi DC, 135); *S'ke me mundune* mej shpëtuom mpkatit e së keqesë ashtu as *me u shëndoshunë* e *me u*

²⁹ Khs. S. Mansaku, *art. i cit.*, f. 144.

³⁰ S. Mansaku, *art. i cit.*, f. 143.

dëlijrunë prej nci (Budi, SC, 162); *me u lulëzuom...* udhëtë (RR, 233); Natyra e këtyne qiellje është gjithëherë *me u luejtune*, me gjithë sa këtu profundi vëhetë roe “la natura di quefti Cieli è di sempre muoverci, con quello di più, che quindi sotto più distintamente li nota” (Bogdani I, 25); mbasi pat përmetuem *me u tënduem* ndë shkretëti “dopo hauere permelfo d’essere tentato nel Deferto” (II, 48); e Lazeri fort i vobek dëshëronte *me u nginjunë* dromcash, qi rrëzoheshinë ndënë triesë “e Lazaro poveriffimo defideraua di saziarfi delle moliche, che calcauano sotto la Tauola” (II, 82); Aso koheje së pari u duk mballëfaqe nd’Europët, kishavet *me u adheruem* IESUSI “all’hora per prima volta li vide palefamente in Europa adorarfi nelle Bafiliche Giesu” (II, 142); *me u hjekunë* prej grykësijet (Mulaku, 136 / K. i Arbënit, 33); *me u ngjeshunë* me brezi (Mulaku, 136 / K. i Arbënit, 102); *me u shendoshun* e ndë fëdiget së korpit (Mulaku, 136 / Kazazi, 20); *me u idhënuem* (Mulaku, 136 / Kazazi, 36).

2. 1. 1. Përveç se me pjesëzën përemërore **u**, që te Autorët e Vjetër forma joveprore e paskajores mund të shprehet edhe me anë të foljes ndihmëse *jam*, konkretisht me ndërtimin analitik **me + qenë + pjesore**.³¹ S. Mansaku vë në dukje se te Buzuku dhe te Budi gjenden mjaft raste kur paskajorja e foljes ndihmëse *jam* ndiqet nga pjesorja e një foljeje tjetër, p.sh.: *me klenë patë, me klenë munduom, me klenë shpëtuom, me klenë lanë, me klenë dëlirunë, me klenë ngritunë* etj. Kjo gjë mund të ndodhë edhe kur paskajorja joveprore hyn në përbërjen e formave analitike të së ardhmes ose të së ardhmes të së shkuarës, p.sh.: *ke me klenë tradhëtuom, ke me klenë dam, kemi me qenë pyetunë, kish me qenë dënuom, kish me qenë daam* etj.³² Konkretisht, te DC e

³¹ Shih edhe R. Mulaku, *vep. cit.*, f. 136 dhe *Fonetika...*, f. 258 ose *Gramatika e gjuhës shqipe, vep. cit.*, f. 301. Për formimin e pësore në veprat e Autorëve të Vjetër me foljen ndihmëse *vij + pjesore* si ndikim nga italishtja shih Ina Arapi, *Der Gebrauch von Infinitiv und Konjunktiv im Altalbanischen mit Ausblick auf das Rumänische*, Hamburg, 2010, f. 247-251.

³² Lidhur me supozimin që bën ai, art. i cit., f. 145, se ndoshta në vend të pjesores kemi të bëjmë këtu me një përdorim mbiemëror të saj, pra me një mbiemër prej pjesor të paparanyjzuar, na duket se këta shembuj që kemi gjetur te Bogdani nuk lenë vend për asnjë dyshim: E më kthej prej udhet së Derësë Shëjtënimit së përjashtëshime, e silla këqyrënte prej së dalit, e ish mbëshelë: e tha Zotynë mue. Dera këjo *ka me kjanë e mbëshelë*, e nukë ka me u çelë; e burrë nukë ka me shkuem ndëpër tã. Përse Hyji i Izraelit është hīm ndëpër tã, e *ka me kjanë mbëshelë*. Zoti vetë ka me ndenjunë ndë tã, etc. “Et convertit me ad viam Portae sanctuarii exterioris, quae respiciebat ad Orientem, et erat clausa; et dixit Dominus ad me; Porta haec clausa erit, et non aperietur, et vir non tranfiet per eam, quoniam Deus Israel ingressus est per eam; eritque clausa. Princeps ipse fedebit in ea etc.”(I, 128). I njeiti ndërtim na del i përdorur edhe një herë tjetër: keshtu mÿjti mirëfilli me lëm një vajzë bÿrrë vet pa mos i çprishunë virgjininë e sajnaj. Dera këjo, *ka me kjanë mbëshelë*, nukë ka me u çelë. E nierë kje bam brenda sajnaj, e

Budit kemi gjetur gjithsej 29 raste të tilla duke përfshirë edhe 6 rastet në përbërje të së ardhmes analitike. Shpesh kemi të bëjmë këtu me bashkërenditje të disa paskajoreve dhe është interesant fakti që folja *jam*, në rastin konkret *me qenë*, nuk përsëritet, megjithëse midis paskajoreve të bashkërenditura mund të hyjnë fjalë të tjera, bile fjalë të tjera mund të hyjnë ndonjëherë edhe midis vetë foljes *jam* dhe pjesores që pason. Ja disa shembuj nga Budi: ashtu, sikundrëse meriton *me qenë paguom* puna e tyre (DC, 127)³³; faqeja jonë si flakë / frike *me qenë shëmtuom* (176); këta të madh të dashunë duhetë *me qenë ende përziem* me të madh të prunjëtë e të përvuutë (59); sikundrëse do ligja e meriton *me qenë prej neesh gjithëherë lëvduom* e *ndeerunë*, e *jo shaam* e *çmuom* e *marrë ndëpër gojë* (61); përmbii gjithë të tierat ancosh kemi *me qenë pyetunë* (102); E kshtu mbë këtë arrësye tue baam, *kishnjimë me qenë larguom* n gjithë ncë këqishit (38); Ju *kini me qenë vdierrë / e keq idhunë dënuom* (210). Te Bogdani kjo mënyrë për të shprehur formën joveprorë të paskajores ndeshet mjaft rrallë. Kemi numëruar gjithsej vetëm 42 raste të tilla, nga të cilat 9 kur paskajorja përdoret më vete, 29 në përbërje të së ardhmes, 2 në përbërje të së ardhmes së të shkuarës dhe 2 në përbërje të së ardhmes II të të shkuarës.

Cili është dallimi midis formave joveprorë me *u* dhe atyre me foljen ndihmëse *jam*? Në planin funksional nuk shohim të ketë ndonjë ndryshim midis tyre. Format joveprorë me foljen ndihmëse *jam* mund të përdoren në të gjitha ato funksione që përdoren edhe format me pjesëzën përemërore *u*. Këtë na e vërteton edhe fakti që ato edhe mund të bashkërenditen, sidomos kur janë në përbërje të kohës së ardhme, p.sh.: *Kā me u kthjelluem*, ndërë kohet së panjoftunë, e nfshefunë *ka me u leçitunë*, e *ka me kjanë dukunë* gjithë shekullit ngushëllimi Tinezot “Revelabitur, fino à hora incognita, naſcofta, ſi propalarà, e farà nota à tutto il Mondo, Gloria Domini” (Bogdani I, 122); Dera këjo, *ka me kjanë mbëshelë*, nukë *ka me u çelë*. “Porta haec clauſa erit, et non aperietur” (II, 20). Ashtu sikurse format joveprorë me pjesëzën *u*, edhe format joveprorë me

vetë i nalti e bani atà “così pote bene partorire una Vergine il suo figlio senza levarle la Verginità. Porta haec clauſa erit, et non aperietur. Et homo factus est in ea, et ipſe fundauit eam altiffimus.” (II, 19-20). Pra në fillim kemi fjalinë “Dera këjo *ka me kjanë*, e *mbëshelë*”, e nukë *ka me u çelë*”, ku autori pas foljes *ka me kjanë* ka vënë një presje dhe pastaj mbiemrin e *mbëshelë*; në rastin e dytë, po duke iu referuar *derës*, gjejmë “e *ka me kjanë mbëshelë*”, ndërsa në rastin e tretë përsëritet fjalia e parë, por pas *ka me kjanë* është po ashtu pjesorja *mbëshelë*: “Dera këjo, *ka me kjanë mbëshelë*, nuk *ka me u çelë*”. Megjithëse në të tria rastet kuptimi në shqip dhe përkthimi në latinisht është i njëjtë, autori e ka dalluar qartë strukturalisht mbiemrin në fjalinë e parë nga pjesoret në fjalitë e tjera. Me sa duket ai ka shfrytëzuar të dyja mundësitë për të evituar përsëritjen.

³³ Duke pasur parasysh çështjen që shtrohet në fusnotën e mëparshme mund të shtojmë edhe një tjetër argument kundër interpretimit të pjesores si një mbiemër prejpjesor i paparanyjëzuar: nëse do të ishte kështu, përse nuk përshtatet mbiemri *paguom* me emrin *puna*?

foljen ndihmëse *jam* mund të bashkërenditen normalisht me forma veprore, p.sh.: Mojzesi me lot vò te Zotynë, i silli i dha fjalë se *ka me i gjetunë gjellë*, e se *kish me kjanë* bukë *dërguem* n' qiellshit “Moisè con lagrime ricorfe à Dio, quale li diede la parola, che proveredia di softegno, e che faria pane mandato dal Cielo” (I, 92); i silli tue kjanë ndër ata qi po kallëzuekeshinë andërratë, njanit tha, qi *ka me shpetuem* e tjetërit se *ka me kjanë dvjerrë* “il quale ritrouandofì trà coloro, che raccontauano fogni, all'vno dife, che farebbe liberato, et all'altro, che morirebbe applicato” (II, 120).

Në planin semantik bashkohemi me mendimin e shprehur se ndërta format me *u* e shënojnë një veprim thjesht si proces, ato me *jam* e shënojnë veprimin më shumë si rezultat të një procesi, pra e kanë më të theksuar aspektin rezultativ.³⁴ Megjithatë, theksojmë se jo gjithmonë mund ta themi me siguri këtë gjë. P.sh. te: Dera këjo ka me kjanë *e mbëshelë*, e nukë *ka me u çelë*; e burrë nukë ka me shkuem ndëpër tã. Përse Hyji i Izraelit është hîm ndëpër tã, e *ka me kjanë mbëshelë* “Porta haec claufa erit, et non aperietur, et vir non tranfiet per eam, quoniam Deus Ifrael ingressus est per eam; eritque claufa” (Bogdani I, 128) duket qartë se autori ka qenë i ndërgjegjshëm për këtë dallim, sepse ai ka përdorur formën me *u* për të treguar një veprim që do të kryhet, në rastin tonë që nuk ka për t'u kryer në të ardhmen dhe formën me *jam* për të shënuar një fakt konkret, rezultatit e një veprimi që është kryer më parë. Bile, mund të supozohet se ai duhet të ketë qenë i sigurt që ka mënjanuar çdo keqkuptim, pasi që pak më përpara përdor në të njëjtin kontekst në vend të pjesores mbiemrin, i cili e shpreh fare qartë rezultatit e veprimit. Por në shumë raste të tjera është e vështirë që të bëhet ky dallim.

Është interesant se Bogdani ka përdorur të paktën dy herë edhe ndërtimin *pat me qenë + pjesore*, pra me foljen *kam* në kohën e kryer e thjeshtë dëftore, duke formuar në këtë mënyrë një të ardhme II të së shkuarës, me një kuptim kohor që nuk ndryshon shumë nga ai i së ardhmes së të shkuarës: *Pat me kjanë zanë* ndë bark~të s'amësë pa dhünë “faria ftato concetto senza vergogna” (I, 45); e për të njimendë *pat me kjanë dekunë*, ndë mos kjanëke ndimuem prej Hyjënit “e faria veramente morto, fe non foffè ftato aiutato dalla Diuinità” (II, 111). Me sa duket kemi të bëjmë këtu me një fenomen dialektor të kufizuar.

Si përfundim mund të themi se format pësore të ndërtuara me pjesëzën përemërore *u* dallohen nga ato me foljen ndihmëse *jam* si në planin formal, ashtu edhe në atë semantik. Ky dallim është i ngjashëm me atë që bëhet në gjermanishten midis të ashtuquajturave *Vorgangspassiv* dhe *Zustandspassiv*, por këtu nuk mund të thellohemi më tepër në këtë problem, sepse kjo gjë do të kërkonte një studim më vete.

Duke u nisur nga fakti që edhe në italishten forma joveprore e paskajores ndërtohet nga paskajorja e foljes *essere + pjesoren e foljes kryesore*, si p.sh.

³⁴ Khs. S. Mansaku, *art. cit.*, f. 145.

consolare - essere consolato, S. Mansaku ka hedhur idenë e një ndikimi të italishtes në shqip³⁵. Në parim kjo nuk do të ishte e pamundur duke patur parasysh që Autorët e Vjetër ishin që të gjithë klerikë dhe si të tillë e njihnin në një shkallë shumë të lartë këtë gjuhë. Por, duke iu referuar përsëri Bogdanit, i cili e përktheu vetë në italisht librin e tij, mendojmë se në rast se ai me të vërtetë do të qe ndikuar nga italishtja, do të duhej që çdo paskajoreje joveprone në shqipen t'i përgjigjej po një paskajore joveprone në italishten. Në të vërtetë nuk ndodh kështu; afërsisht në 1/3 e rasteve teksti shqip nuk përputhet me atë italisht, përkatësisht latinisht. Ja disa shembuj: Prashtu si shkoj një ditë, u lut *me kjanë gjegjunë*, e të hinte ke Regji “però pafsato un giorno, *dimandò udienda*, che dovelfse elser introdotta dal Rè” (I, 130); i silli tue kjanë ndër ata qi po kallëzuekeshinë andërratë, njanit tha, qi ka me shpëtuem e tjetërit se *ka me kjanë dvjerrë* “il quale ritrouandofi trà coloro, che raccontauano fogni, all’vno diffe, che farebbe liberato, et all’altro, che *morirebbe applicato*” (II, 120); Aqa sa *me kjanë përmetuem* engjijet Parrīsīt të kishinë grabitunë e rrëmbyem “Onde gli Angeli, *le fosse loro stato permesso*, mi t’haverebber tolto” (II, 122). Në rastin e parë paskajores shqipe i përgjigjet në italisht një folje në kohën e ardhme të mënyrës dëftore, në rastin e dytë një folje në kohën e tashme të mënyrës kushtore + mbiemër dhe në rastin e tretë një folje në kohën e kryer e tejshkuar. Sidomos interesant është shembulli i mëposhtëm, ku autori paskajoren joveprone të shqipes e ka përkthyer në italisht me lidhore, ndërsa lidhoren me paskajore joveprone: t’sijet e përmetoj Zotynë *me kjanë* mbë këtë jetë *munduem*, qi *të jenë* mbë tjetërët jetë *paguem* “alli quali permise DIO *fiano* in questo mondo *tormentati*, per *esser* nell’altra vita poi *remunerati*” (II, 77). Këto mospërputhje që shohim te Bogdani na bëjnë që ta quajmë të papranueshme tezën e një ndikimi nga italishtja.

Për një ndikim nga italishtja mund të flitet në katër shembujt e mëposhtëm, kur në vend të foljes ndihmëse *jam*, por me të njëjtin funksion si ajo, është përdorur një tjetër folje, konkretisht tri herë folja *me mbetunë* dhe njëherë ajo *me u gjetunë*: përse një tjetër herë *me mbetunë tradhëtuem* së shtremunash punësh së tuash “imperoche, *le un altra fiata io restaffi tradito* dalli tuoi falsi; et predestinati tratti” (Pleqënia e Shtëpisë Bogdananjet, faqja e dytë, rrjeshti 37); tjetëra pjesë kish për të qëndruem e shëndoshë e dërejt tue ndjekunë Krishnë, e *kish me mbetunë bekuem* me sakramen të shëjtesë Kishë “l’altra parte dovea restar fana, e dritta con ricever Christo, e la verità della fua S. legge Per. il 5. previdde, qualmente quel Popolo, che era per ricever Christo, *dovea restar benedetto* con li Sacramenti della S.Chiefa” (I, 81); Dërgoj Zotynë të shtatënë menī, qi kje breshënë, bumbullimë e vetëtimë. U duk se për këta *kish me mbetunë* Faraoni *penduem* “Mandò Dio la settima avverfità, che fù Tempesta, Tuoni, e baleni. Parve, che per questo *restaffe* Faraone *compunto*” (I,

³⁵ S. Mansaku, *ibidem*.

90); E mjerë ata qi përzënë shërbëtoretë e Tinëzot, e kanë vum shpëresën' e tyne mbë gjã të kësaj jete, përse kanë me u gjetunë dënuem “mà miferi quelli, che perseguitano li ferui di DIO, e hanno collocato la loro sferanza sù l'interessi di questo Mondo, perche *fi trouarano dannati*” (II, 59). Ashtu si folja *jam*, edhe këto tregojnë një gjendje ose një fakt që vjen si rezultat i një veprimi të kryer nga dikush tjetër. Siç shihet, ky tip paskajoreje është përdorur një herë më vete dhe tre herë në përbërje të kohës së ardhme. Që këtu kemi të bëjmë me paskajore joveprore dhe jo me paskajore + mbiemër prejpsesor të paparanyjzuar na e përforcon shembulli i dytë, ku *kish me mbetunë... bekuem bashkërenditet me kish për të qëndruem e shëndoshë*. Në italishten paskajoreve joveprore shqipe u përgjigjen në rastin e parë dhe të tretë folja *restare* “mbetem” në kohën e pakryer të mënyrës lidhore + pjesorja e foljes kryesore, në rastin e dytë folja *dovere* në të pakryerën + *restare* në paskajore + pjesorja e foljes kryesore dhe në rastin e fundit *trovarsi* “gjemhem” në kohën e kryer e thjeshtë të mënyrës dëftore + pjesorja e foljes kryesore.

Një problem mjaft të ndërlikuar paraqesin rastet kur, që nga Buzuku e më vonë, folja ndihmëse *jam* është përdorur edhe për të ndërtuar diatezën joveprore të kohës së tashme të mënyrës lidhore. Te Budi kemi gjetur 39 ndërtime të tipit *jam në kohën e tashme të mënyrës lidhore + pjesore*, 6 të tipit *jam në kohën e pakryer të mënyrës lidhore + pjesore* dhe 1 të tipit *jam në trajtën të qe + pjesore*. Në këtë numërim bashkërenditjet janë konsideruar si një ndërtim i vetëm, sepse folja *jam*, si zakonisht te Budi, edhe këtu nuk përsëritet. Ndërsa te Bogdani kemi konstatuar 29 ndërtime të tipit *jam në kohën e tashme të mënyrës lidhore + pjesore* dhe 23 të tipit *jam në kohën e pakryer të mënyrës lidhore + pjesore*. Në një vështrim të parë do të supozonim që këtu kemi të bëjmë me folje në kohën e kryer, përkatësisht më se të kryer të mënyrës lidhore. Mirëpo, bie menjëherë në sy se gati gjysma e ndërtimeve me foljen *jam në të tashmen e lidhores + pjesore* shprehin kuptime kohore që ngjasojnë më tepër me ato që shpreh koha e tashme e kësaj mënyre. Ja disa shembuj të tillë: *Duhetë* qi ato misteria të jenë dëftuem profetësh si ndë një pasëqyrë ndë ndivenesë “*fi ricerca, che tali Misterii fiano rappresentati al Profeta in qualche oggetto enigmatico*” (I, 55 - ndikim nga italishtja?); Ashtu nuk përmetoj Zotynë qi Jezu Krishtit të jenë thyem duertë e kambëtë për urdhëni të Pilatit “*Di più non permise Iddio, che à Giesù Christo fossero rotte le braccia, e li piedi per commandamento di Pilato*” (I, 65); aq keq i erdh Saulit sã urdhenoj qi Abimeleku Prift të jetë vrãm me të tjerë 85 Priftenë “*s'offese Saul in tal maniera, che cõmadò fosse detto Abimelech Sacerdote vccifo con altri 85. Sacerdoti*” (I, 100); i thanë: legja e Mojzesit... thotë se këjo grue të jetë vrãm n'gurë “*li differo; la legge di Moisè dice... che questa donna sia lapidata*” (II,76); E kam me bãm qi gjithëkush të mos adhëronjë fëtyrën e bishesë të jetë vrãm “*Et faciet, vt quicunque non adorauerint imaginem bestiae, occidantur*”

(II, 156) etj. Ndërtimet e nënvizuara shprehin një veprim të mundshëm ose të domosdoshëm që mund ose duhet të kryhet pas çastit të ligjërimit duke u bashkuar në këtë mënyrë me kohën e tashme të lidhore, në dallim nga e kryera që tregon një veprim që mund ose duhet të ishte kryer para çastit të ligjërimit. Edhe në tekstin italisht atyre u përgjigjen folje ose në kohën e tashme, ose në të pakryerën e mënyrës lidhore, ndërsa një herë në përkthimin latinisht një folje në koniuktivin I; në ndonjë rast tjetër gjejmë edhe paskajoren e përbërë ose të tashmen e mënyrës dëftore.

Mirëpo ka dhe mjaft raste kur ndërtimi *të jem + pjesore* është përdorur me vlerën e zakonshme, d.m.th. atë të kohës së kryer të mënyrës lidhore, p.sh.: si thotë Filozofi: Asgja nukë është ndë mend, qi ma para *të mos jetë shkuem* ndëpër shqisë “come dice il Filosofo, nihil est in intellectu, quod prius non fuerit in fenfu” (I, 56); Votnë ke Pilati, i thanë se të mos vini regji i jevrejet. Tha Pilati, qish shkrova le *të jetë shkruem* “andarono à Pilato, e gli differe, che non volesse mettere Rè de’ Giudei. Rispose Pilato: ciò, che hò scritto, fia scritto” (II, 118); kush kish me kjanë aj qi të mos kjan? Tue pam se ndë tÿ nuk’është vend, qi *të mos jetë përlym e përgjakunë?* “qual farebbe quello, che dirottamente non piangesse? vedendo, che in te non vi è parte alcuna, che non fia guasta, e di langue tutta macchiata ?” (II, 122); Për një si *të jetë zanë* ndë bark të s’amësë kanë me i hīm djemënitë “Come farà concepito nel ventre della sua Madre, li entreranno nel corpo li Demonij” (II, 155); Mbasi *të jetë* shekulli gjithë *djegunë* me zjarm, ka me u kulluem dheu me gjithë të tjerë elementa “Come farà il Mondo tutto bruggiato con il fuoco, si purificarà la terra con tutti li altri Elementi” (II, 159) etj.³⁶ Në përkthimin italisht këtyre ndërtimeve u korrespondojnë zakonisht folje në kohën e ardhme të mënyrës dëftore, por në shembujt e mësipërm del dy herë edhe e tashmja e lidhore, bile një herë në formën e ndërtimit *të jetë + mbiemër* “sia guasta”, çka nuk do të thotë që edhe tekstin shqip duhet ta interpretojmë patjetër në këtë mënyrë.

Në këto kushte është normale që të shtrohet pyetja: si do t’i dallojmë këto dy grupe nga njeri-tjetri? Mendojmë që para së gjithash duhet të analizojmë me kujdes se çfarë kuptimi kohor shpreh ndërtimi në fjalë. Nëse ai shënon një veprim që do të kryhet në të ardhmen, kemi të bëjmë me kohën e tashme pësore

³⁶ Sipas *Gramatika...*, *vep. cit.*, f. 325-326: “Kuptimi themelor i së kryerës së lidhore është të tregojë një veprim, që mund të jetë kryer para çastit të ligjërimit, me të cilin nuk i ka të këputura lidhjet... e kryera e lidhore përdoret kryesisht në fjali të varura kryefjalore e kundrinore... në fjali të varura kohore (të ndërtuara me lidhëzat *kur, si, pasi* etj.) ... Në fjalitë e varura kohore e kryera e mënyrës lidhore shpreh kuptimin e një veprimi të mundshëm, që pritet të ndodhë në të ardhmen, para veprimit të emërtuar nga folja e fjalisë drejtuese. Në këtë rast ajo është e barasvlershme me të ardhmen e përparme të dëftores dhe përdoret në korrelacion me një folje të kohës së ardhme në fjalinë kryesore”.

të mënyrës lidhore të ndërtuar me anë të foljes ndihmëse *jam + pjesore*, nëse shënon një veprim që është kryer më parë kemi të bëjmë me kohën e kryer të mënyrës lidhore.

Por, mund të themi se edhe nga pikëpamja formale këto dy grupe diferencohen relativisht qartë: ndërtimi të *jem + pjesore* përdoret me vlerën e kohës së tashme të mënyrës lidhore pothuajse gjithmonë në *fjali të varura kundrinore*, kur folja e fjalisë drejtuese shpreh një vullnet a dëshirë. Te Bogdani këto janë në pjesën më të madhe të rasteve foljet “urdhëroj” dhe “premtoj” në formën e së kryerës së thjeshtë, përkatësisht *urdhënoj* dhe *përmetoj*, *duhet*, *them* etj. Ndërsa me vlerën e së kryerës së lidhores ndërtimi të *jem + pjesore* përdoret sidomos në *fjali të varura kohore* të paraprirra nga lidhëzat *mbasi, si, kur* dhe shumë rrallë në *fjali të varura kryefjalore*. Por ndërtimi të *jem + pjesore* është përdorur me vlerën e lidhores së tashme edhe në lloje të tjera fjalish, p.sh. më poshtë në fjali qëllimore ose të pavarur: t`sijet u përmetoj Zotynë *me kjanë* mbë këtë jetë *munduem*, *qi të jenë* mbë tjetërët jetë *paguem* “allì quali permise DIO *fiano* in questo mondo tormentati, per *esser* nell’altra vita poi *remunerati*” (Bogdani II, 77); Motit kur *kā me kjanë* *hjekunë* mirëfilli sakrificia, e *të jetë* *vum* madhështia ndë shkretëtì “A tempore cùm *ablatum fuerit* iuge Sacrificium, et *posita fuerit* abominatio in desolationem” (II, 156). Në shembullin e fundit e tashmja pësore e lidhores me *jam* është bashkërenditur me të ardhmen pësore me *jam* dhe të dyjave u korrespondon në tekstin latinisht koha e ardhme II.

Formën joveprore me *jam* e gjejmë edhe atëhere kur koha e tashme e lidhores është përdorur me vlerën e së ardhmes: E kur t u sjellënë, bani të mos kujtoni si e qish ju të flitëni, përse ùd atë ças *t u jetë dhanë* ta qish ju të kini me folë “Cum autem tradent vos, nolite cogitare quomodo aut quid loquamini: dabitur enim vobis in illa hora quid loquamini” (Buzuku II, 355).

Siç thamë që në fillim, përveç të *jem + pjesore* Bogdani përdor edhe ndërtimin të *isha + pjesore*, sidomos në fjali të varura mënyrore të paraprirra nga lidhëza *posikur*, kushtore të paraprirra zakonisht nga lidhëza *ndonëse* dhe më rrallë në fjali të varura kryefjalore, kundrinore ose të pavarura, p.sh.: Platoni ende tha një fjalë *posikur t`ish dalë* gojet së Shë Gjonit. “Platone pure diffe una parola, come se *fosse uscita* dalla boca di San Giouanni” (I, 10); Ashtu qi me të dashunë *t`ishinë* fort *lidhunë* të dy e *shtërguem* me ligj “accìò *foffero* con amore *vincolati*, e *stretti* ambedue.” (I, 46); E aj u thoj atyne: Ju kini dalë me më marrë posi të *jeshë kjanë* një kusar “Et egli dicea loro: voi sete uenuti à pigliarmi, come, se *io foffi stato* un ladro” (II, 100); Kish dashunë ajo gjind e paudhë qi *t`ishinë ndodhunë* me tâ ende SS. Apostujë për të shqimbunë mirëfilli emenitë tìnaj “Haueria voluto quella peruerfa gente, che *foffer trouati* feco anche li Santi Apostoli per estinguere affatto la loro memoria” (II, 101); Ma mirë pat me kjanë të *jeshe unë* *dekunë* perpara, ti të mbëshilnje sýt`e mī “Meglio era, che io *foffi morta*, prima che tu haueffi nella morte mia chiufi gli

occhi miei” (II, 122); Ndonëse të miretë sa kjenë mbë këtë jetë *t'ishinë rrëzue* ndë ndonji faj së sillit *t'ishinë penduem* “Ancorche li buoni mentre furono in questo Mondo, *fossero cafcati* in qualche colpa, della quale *fi fossero pentiti*, e fatto la penitenza” (II, 159). Në 3/4 e rasteve në tekstin italisht gjejmë një folje në të pakryerën e mënyrës lidhore.

Në simetri me të parin do të prisnim që edhe ndërtimi të *isha + pjesore* të kishte herë vlerën e kohës më se të kryer, herë atë të kohës së pakryer të mënyrës lidhore. Por, na duket se ai përdoret pothuajse gjithmonë me vlerën e zakoshme që ka edhe sot, pra me atë të kohës më se të kryer të mënyrës lidhore, duke shënuar një veprim të mundshëm për t'u kryer para një çasti të caktuar të së shkuarës. Vetëm në dy shembujt e mëposhtëm kemi përshtypjen sikur të *isha + pjesore* është përdorur më tepër me vlerën e së pakryerës së lidhores, sepse tregon thjesht një veprim që kryhet në të shkuarën: Do Jezu Krishti me na lanë këtë shëjt Sakramend për një peng të dashunit vet t'madhit... ashtu qi me Gjq, *t'ishim mbajtunë* (= të mbaheshim “të detyroheshim”) me dashunë e me shërbyem “Volle parimente lasciarci GIESU'CHRISTO quefto Santillimo Sacramento per vn pegno del fuo grande amore... acciò per via di Giuftitia, e gratitudine *fiam afiretti* ad amarlo, e feruirlo.” (II, 95); sa nukë dij se Zotynë a mundej me bām ma teperë kur *t'ish ardhunë* (= të vinte) ndër nierez “che non lò, fe Iddio hauellè potuto far di più quando *fosse* trà gl'huomini venuto” (II, 133).

Si përfundim mund të themi se në sistemin foljor të kësaj periudhe vihet re një konfuzion, që vjen ngaqë folja ndihmëse *jam* është përdorur edhe për formimin e diatezës pësore të kohës së tashme të mënyrës lidhore, edhe në funksionin e saj të zakonshëm për formimin e kohës më se të kryer të kësaj mënyre duke krijuar kështu dy forma homonime. Është e vështirë të zbulohet nëse vetë autorët kanë qenë të ndërgjegjshëm për këtë gjë. Përsa i përket arsyes së kësaj dukurie mund të bëjmë vetëm dy supozime: ndoshta kemi të bëjmë me një ndikim nga italishtja, sepse në këtë gjuhë folja *jam* është e pranishme në formimin e të gjithave kohëve të mënyrës lidhore në diatezën pësore³⁷; ose kjo gjë ndodh nën ndikimin e ndërtimeve me paskajore, megjithëse këtu është njëllë e mundshme edhe e kundërta, d.m.th. që lidhoret të kenë ndikuar te paskajorja. Një vështirësi për supozimin e fundit është fakti që te paskajorja joveprore folja *jam* del në formën e saj të ngurosur të paskajores *me qenë*, ndërsa te lidhorja ajo zgjedhohet, çka tregon se nuk mund të bëhet fjalë për një kalim mekanik të foljes *jam* nga njëra formë te tjetra.

³⁷ Në italisht diateza pësore e mënyrës lidhore paraqitet si më poshtë: E tashme - sia lodato, a; siamo lodati, e; E pakryera - fossi lodato, a; fossimo lodati, e; E kryera - sia stato, a lodato, a ; siamo stati, e lodati, e; Më se e kryera - fossi stato, a lodato, a ; fossimo stati, e lodati, e.

2. 2. Kategoria gramatikore e kohës. Ashtu si në shumicën e gjuhëve që kanë paskajore, edhe në shqip dallojmë formalisht dy forma të saj: *të tashmen* dhe *të shkuarën*. Paskajorja e tashme, siç e kemi përmendur që në fillim, formohet nga pjesëza *me* + pjesorja e foljes që zgjedhohet, p.sh. *me punue*, ndërsa paskajorja e shkuar nga paskajorja e foljes ndihmëse *kam* + pjesorja e foljes që zgjedhohet, p.sh. *me pasë punue*. Theksojmë edhe njëherë që ndërtimi *me qenë* + *pjesore*, të cilin e analizuam hollësisht në pikën 1, nuk është formë e paskajores së shkuar, por e paskajores së tashme joveprore. Forma joveprore e paskajores së shkuar, ashtu si ajo e së tashmes, ndërtohet me anë të pjesëzës përemërore *u* që vihet midis pjesëzës *me* dhe pjesores. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur të gjitha trajtat e paskajores në gjuhën shqipe në funksion të diatezës dhe të kohës:

KOHA	DIATEZA VEPRORE	DIATEZA PËSORE
E tashme	me punue	me u punue / me qenë punue
E shkuar	me pasë punue	

Një veçori e paskajores shqipe është që sistemi i formave kohore të saj nuk është simetrik: paskajorja e shkuar paraqet kundrejt paskajores së tashme disa kufizime. Së pari, paskajorja e shkuar te Autorët e Vjetër gjendet në përgjithësi shumë rrallë, ndërsa te Buzuku mungon fare. Te Bogdani kemi numëruar gjithashtu një numër tepër të vogël rastesh, gjithsej tre, të gjitha në formë veprore. Së dyti, paskajorja e shkuar në gjuhën shqipe përdoret vetëm me një funksion sintaksor të caktuar: si kallëzues i një fjalie kushtore në një periudhë hipotetike. Në këtë funksion e hasim si te Autorët e Vjetër, ashtu edhe te ata të mëvonshmit, p.sh.: jo për forcë të përmbrëshime, përse *me i pasë rām patërshanë* kish me pasë mbytnë “non per Virtù inherente, perche *se li fosse, stato tirato* una lanciata, l’haueria vccifo” (Bogdani I, 44-45); përse *me mos pasunë aj dashunë* me kjanë udhë, gjithëherë kishim me u ngënjem “fi enim via ipse esse *noluisse*, semper erraremus” (II, 42); tue i thanë, se aj mundën me bam me u djergunë prej qiellshit për ta ndimuem, *me pasë dashunë*, shumë legjiona engjijsh “foggiungendoli: che egli havria potuto far scendere dal Cielo à sua diffesa, *se haueffe voluto*, molte leggioni d’Angioli” (II, 100).

Përveç kësaj, te Bogdani paskajoren e shkuar e gjejmë edhe në përbërje të kohës *e ardhme e përparme e së shkuarës*, e cila gjithashtu përdoret në fare pak raste: Përse me mos kjanë ashtu, Abrami nukë *kish me pasë thanë* atyne tre vetëve O Zot “perche se tale non fosse, *detto* altrimenti Abramo non *haverebbe* à quelle tre persone, Signore” (I, 12); përse me i pasë rām patërshanë *kish me pasë mbytnë* “perche se li fosse, stato tirato una lanciata l’haueria vccifo” (I, 44-45); po mirëfilli ndjeu ndë shpirt të vet një të dhimptunë aqa të madh, sa ndë

mos kjanëke prej Sinëzot fort ndimuem, *kish me pasunë dekunë* së dhimptuni “mà ben fì fenti nell’anima fua un così intento dolore, che fe non foffe ftata da DIO molto fauorita, et aiutata *farebbe morta* di dolore” (II, 105); po vinte me pãm a të gjante mëngjī, tue kujtuem se Jezu Krishti *kish me pasunë ikunë* duershit së jevrejet “ueniua à uedere, fè ui potea trouar rimedio: effendofì imaginato, che GIESV CHRISTO *haueria fuggitto* dalle mani de Giudei” (II, 105).

Kufizimi i dytë ndikon në njëfarë mase mbi të parin, sepse vetëkuptohet që frekuenca e përdorimit bie tepër nëse një formë gramatikore lejon të përdoret vetëm me një funksion sintaksor të caktuar. Më tutje mendojmë që të dyja këto kufizime burojnë nga vetë natyra e paskajores si forma përfaqësuese e foljes që e tregon një veprim thjesht si proces, qoftë në të tashmen, qoftë në të kaluarën, qoftë në të ardhmen, pra në mënyrë të përgjithshme dhe të papërcaktuar në kohë. Prandaj, me sa duket, edhe trajta e shkuar e paskajores shqipe është formuar në kushte sintaksore specifike, konkretisht, atëhere kur konteksti kohor kushtëzohet dhe qartësohet nga ai sintaksor, pasi është e qartë që folja-kallëzues e fjalisë kushtore në periudhën hipotetike shënon një veprim, i cili duhet të kryhet para atij që shënon folja-kallëzues e fjalisë kryesore. Por, meqenëse në periudhat hipotetike të këtij tipi folja-kallëzues e fjalisë kryesore shënon një veprim të mundshëm për t'u kryer në të ardhmen, edhe folja-kallëzues e fjalisë kushtore e shprehur me paskajore të shkuar shënon po një veprim të mundshëm për t'u kryer në të ardhmen, veçse përpara atij të fjalisë kryesore. Pra, si përfundim mund të themi se paskajorja e shkuar në shqipen e vjetër përdoret në fakt me kuptimin kohor të së ardhmes. Si rrjedhim, mund të thuhet se kategoria gramatikore e kohës te paskajorja shqipe ka vlerë fiktive dhe jo reale.

Përsa u përket kuptimeve kohore që shpreh paskajorja e tashme duhet të dallojmë së pari paskajoren e pavarur nga ajo e varur. Paskajorja e pavarur përdoret zakonisht me kuptimin kohor të së tashmes, sidomos të së tashmes mbarëkohore dhe të së ardhmes. Paskajorja e varur ka një kuptim kohor të kushtëzuar nga kuptimi kohor i foljes drejtuese.³⁸

Përsa paskajorja shqipe nuk ka arritur të zhvillojë një sistem simetrik formash kohore dhe a lidhet kjo gjë me moshën e saj në këtë gjuhë. Mendojmë se një nga arsyt kryesore që e ka penguar zhvillimin e një sistemi të tillë është konkurrenca që i është bërë formës së paskajores së shkuar, në periudhat më të hershme, më shpesh nga paskajorja e tashme dhe më rrallë nga lidhorja, ndërsa më vonë kryesisht nga lidhorja dhe më pak nga paskajorja e tashme. Për këtë arsye ky fakt nuk mund të provojë me siguri që paskajorja e shqipes ka një moshë relativisht të re. Megjithatë, ai na tregon që edhe në periudhën e shqipes së shkruar zhvillimi i paskajores nuk kishte përfunduar ende dhe se ai vazhdonte paralelisht me atë të formave të tjera foljore. Në këtë pikë,

³⁸ Shih *Fonetika...*, f. 234 dhe 288-289, si dhe *Gramatika...*, f. 274 dhe f. 333-334.

paskajorja dallohet nga format e tjera të pashtjelluara, konkretisht nga përcjellorja dhe ajo e tipit *pa + pjesore*, të cilat kanë arritur të krijojnë një sistem simetrik formash kohore. Kështu, që te Buzuku shohim të përdoret rregullisht përcjellorja e tashme, p.sh. *tue bam* dhe ajo e shkuar *tue pasunë bam*. Te Bogdani na duket se kemi gjetur një rast, kur edhe forma e pashtjelluar *pa + pjesore* është përdorur në kohën e shkuar: E unë po thom, se të lum kanë me kjanë ata, qi *pā* mos më *pasunë pām*, kanë me më besuem “Et Io dico, che beati faranno quelli, che fenza hauermi veduto in me crederanno” (II, 136).

Përfundim

Duke pasur parasysh çështjet që u diskutuan në këtë kapitull mund të nxirren këto përfundime kryesore:

Shqipja e sotme ka dy forma të pashtjelluara analitike, të cilat mund të përdoren me ato funksione sintaksore që janë karakteristike për paskajoren e gjuhëve i.e.: *me punue* dhe *për të punue / për të punuar*. Forma e tipit *për të punue / për të punuar* është e mbarë gjuhës, d.m.th. gjendet në të dyja dialektet kryesore, prandaj për pasojë është edhe normative. Mirëpo ajo mund të përdoret vetëm me disa nga funksionet tipike të paskajores, pra është një paskajore me funksione sintaksore të kufizuara. Ndërsa forma e tipit *me punue* që gjendet vetëm në dialektin gegë përdoret me të gjitha funksionet që ka paskajorja edhe në gjuhët e tjera i.e. Prandaj, në këtë punim jemi përqëndruar në radhë të parë te paskajorja gege e tipit *me punue*.

Në këto kushte është normale që sa herë që bie fjala për infinitivin në gjuhën shqipe të lindë vetvetiu pyetja: po dialekti toskë a e ka pasur ndonjëherë paskajoren e tipit *me punue*? Çështja nëse paskajorja e tipit *me punue* ka ekzistuar ndonjëherë edhe në toskërishten përbën një pikë qendrore në historinë e infinitivit në gjuhën shqipe, që është diskutuar dhe vazhdon të diskutohet ende, sepse nga zgjidhja e saj varet edhe nëse mund të flitet apo jo për zhdukje të tij nga kjo gjuhë, si dhe për arsyet që do ta kishin shkaktuar atë. Këtë problem e vështirëson tepër sidomos dokumentimi i vonë me shkrim i gjuhës shqipe. Konkretisht, në dokumentin e parë më të rëndësishëm të toskërishtes, në tekstin “E mbsuame e krishterë” të Lekë Matrëngës, nuk gjendet asnjë gjurmë e kësaj paskajoreje. Prandaj, sa kohë që mungojnë të dhënat konkrete, të gjitha supozimet që mund të sillëshin në favor të një teze të kundërt mbeten në nivelin e hipotezave. Përkundrazi, në dialektin gegë, që në dokumentet më të hershme, paskajorja na paraqitet si një formë foljore e ngulitur mirë me tipare morfologjike, sintaksore dhe semantike të përcaktuara saktë.

Përsa i përket mënyrës së formimit mund të thuhet se pjesëza *me*, dikur parafjalë, tashmë është desemantizuar plotësisht dhe është shndërruar në një morfemë të pamungueshme të paskajores. Pjesa e dytë në planin sinkronik përkon plotësisht me pjesoren, ndërsa historikisht, sipas mendimit më të përgjithshëm ajo duhet të jetë formuar nëpërmjet verbalizimit të një emri

prejpesor në një rasë të caktuar. Prandaj, mund të thuhet se për nga mënyra se si është formuar, paskajorja shqipe përkon plotësisht me paskajoret e gjuhëve të tjera i.e.

Gjatë periudhës letrare të gjuhës shqipe, që nga dokumenti i parë i shqipes së shkruar e deri më sot, struktura fonetike dhe morfologjike e paskajores *me punue* ka ndryshuar vazhdimisht. Siç e paraqitem hollësisht më lart, te të ashtuquajturit Autorë të Vjetër struktura fonetike e paskajores paraqitet në përgjithësi e njësuar. Pa dyshim që një rol të rëndësishëm kanë luajtur këtu edhe përpjekjet e ndërgjegjshme që bënë ata për të kapërcyer kufijtë e dialektit të tyre dhe për të shkruar në një shqipe letrare.³⁹ Megjithatë, nëse në të folmet, të cilave u përkisnin, paskajorja do të kishte pasur një strukturë fonetike shumë më të ndryshme nga ajo e gegërishtes letrare të kohës, mendojmë që në njëfarë mënyre ata do ta kishin pasqyruar këtë gjë në veprat e veta. Prandaj, na mbetet të besojmë që të folmet geqe të asaj kohe në këtë pikë nuk duhet të dalloheshin shumë njëra nga tjetra.

Por edhe në këtë periudhë, ku struktura fonetike e infinitivit paraqitet pak a shumë unitare, vihen re aty-këtu lëkundje nga norma e përgjithshme. Këto lëkundje mund të përmbliidhen në disa drejtime kryesore:

a. Zhdukje e prapashtesave. I tillë është rasti i prapashtesës *-të* që shfaqet te Buzuku, por te asnjëri nga autorët që vijnë pas tij.

b. Rënie ose reduktim i prapashtesave. P.sh. prapashtesa *-m*, e cila duke filluar që te Budi, Bogdani etj. mund të mos vihet fare. Po kështu te Budi, Bogdani dhe Kazazi ka raste kur edhe prapashtesa *-unë/-un* mungon.

c. Rënie e tingujve fundorë të prapashtesave. Kështu te Kazazi, që është autori më i vonë, tingulli fundor i prapashtesave *-në* dhe *-unë* bie dhe si pasojë këto dalin zakonisht me trajtat *-n* dhe *-un*.⁴⁰

ç. Përzierje e prapashtesave. Kështu alternohen p.sh. te Buzuku të tria prapashtesat *-të*, *-m* dhe *-në*. Te Budi në vend të prapashtesës *-unë* është përdorur afërsisht 11 herë prapashtesa *-m*. Ndërsa te Bogdani në vend të prapashtesës *-në* është përdorur të paktën dy herë prapashtesa *-unë*. Edhe te K. i Arbënit kemi vënë re një rast kur *-unë* është përdorur në vend të prapashtesës *-ë*, ndërsa te Kazazi kjo gjë ndodh rregullisht.

³⁹ Siç na e dëshmon p.sh. P. Bogdani në parathënien e librit të tij “Çeta e profetëve”.

⁴⁰ Sipas mendimit tonë rënia e tingullit fundor *-ë* te këto prapashtesa është nga shenjat e para të prirjes që ka sot gegërishtja për ta humbur në përgjithësi *ë-në* e patheksuar në fund të fjalës. Lidhur me këtë E. Çabej, “Studime gjuhësore”, vëll. III, Prishtinë 1976, f. 96, thotë: “Në fund të fjalës *ë-ja* atone në gegërishten bie, duke u zgjatur vokali i silabës së mëparshme: tosk. *nënë*; geg. *nân*, tosk. *fushë*, geg. *fūsh*. Edhe italo-shqiptarët e humbasin këtë *-ë* në fund të fjalës... Te shkrimtarët e vjetër gegë *ë-në* atone e gjejmë të plotë në të gjitha pozicionet, si pretonike si postonike. *Ë-ja* atone sot edhe në toskërishtet ka zën' e merr tatëpjetën”.

d. Mbikarakterizim, bashkim i dy prapashtesave në një të vetme. E tillë është prapashtesa *-nun* që ndeshim te Kazazi.

Këto shmangie, që në periudhën e parë vihen re vetëm aty-këtu në mënyrë të izoluar, tregojnë megjithatë që inovacionet kishin filluar. Por, sigurisht është e pamundur të përcaktohet me saktësi se në cilën ose në cilat të folme, respektivisht te cili autor dhe në cilën kohë u shfaq dhe pastaj u ngulit për herë të parë një ndryshim i caktuar.

Periodha e dytë na dëshmon një pamje shumë më komplekse dhe shumë më të parregullt, ku vihen re ndryshime të rëndësishme në strukturën fonetike të pjesores / paskajores. Prirjet e mësipërme fillojnë të thellohen gjithnjë e më tepër e të bëhen mbizotëruese.

a. Rënia e prapashtesave bëhet masive. Kështu te Guagliata dhe Jubani, me përjashtim të rasteve me prapashtesën *-në*, pjesorja / paskajorja del në përgjithësi pa prapashtesë. Por që më parë te Dh. Todhri kemi vënë re të paktën një rast kur prapashtesa *-un* te paskajorja mungon. Është me rëndësi të vihet në dukje që te Guagliata dhe Jubani prapashtesa *-m* ruhet në shumë raste te pjesorja. Te Guagliata edhe prapashtesa *-un* gjendet te shumë pjesore dhe mbiemra prejpjesorë, por jo te paskajorja.

b. Formohen të tjera prapashtesa të përbëra. Në fillim te Dh. Todhri dhe më vonë te Jubani gjejmë prapashtesën e përbërë *-mun*. Prapashtesa *-nun* që e ndeshëm për herë të parë te Kazazi shfaqet tani edhe te Jubani e Kristoforidhi.

c. Rastet e përzierjes së prapashtesave shtohen: Që te A. i Elbasanit dhe Dh. Todhri *-m*-ja është bashkuar edhe me pjesoret e foljeve më bashkëtingëllore. Te të dy këta, si edhe te Guagliata, Jubani e Kristoforidhi mjaft herë te pjesorja, dhe më rrallë te paskajorja, në vend të prapashtesës *-ë* gjejmë *-un(ë)*. Te Guagliata, Jubani dhe Kristoforidhi, sidomos te pjesorja, prapashtesa *-në* alternohet mjaft shpesh me *-nun*.

Si prirja kryesore dhe më e rëndësishme ndër këto të tria mendojmë se duhet vështruar rënia e prapashtesave, ndërsa dy të tjerat kushtëzohen prej kësaj dhe njëkohësisht e presupozojnë atë. Më konkretisht do të thoshim se përzierja dhe formimi i prapashtesave të përbëra, d.m.th. mosidentifikimi i saktë i tyre dhe gjendja konfuze që u krijua si rezultat i kësaj, duhet të ketë qenë faza paraprake që u shkaktua nga mënjanimi, pra rënia ose humbja e tyre. Nga ana tjetër, mosidentifikimi i saktë i prapashtesave e thelloi akoma më tej rënieën e tyre. Me interes është fakti që shpeshherë prapashtesat janë zhdukur tashmë nga paskajorja, por ruhen te pjesoret dhe emrat e mbiemrat prejpjesorë. Kjo lidhet ndoshta me njëfarë diferencimi që kishte filluar të bëhej në ndjenjën gjuhësore të folësve midis formave foljore të pjesores e të paskajores, si edhe me stabilizimin e kësaj të fundit si formë foljore më vete, megjithëse analitike.

Konfuzioni që ekzistonte në strukturën formale të pjesores, përkatësisht paskajores, u fiksua edhe në gramatikat shqipe të kohës. Kështu, për shembull, në “Gramatika shqyp” të Anton M. Xanonit, që u botua më 1909, gjenden disa

variante të pjesores për të njëjtën folje, të formuara me të gjitha prapashtesat që ishin në përdorim, p.sh. për foljen *ndaj* jepen variantet *da*, *daam* dhe *daamun*, për *lut* gjejmë *lutë* dhe *lutun* etj.

Një veçori tjetër e kësaj periudhe është se ndryshimet fonetike fillojnë të prekin tani edhe vetë temën foljore. Të tilla janë rastet e hapjes dhe sidomos të reduktimit të diftongëve, pra të monoftongimit të tyre⁴¹, raste që kanë ardhur vazhdimisht duke u shtuar. Kështu monoftongimi i diftongëve të temave foljore përbën sot një tipar të rëndësishëm të pjesës më të madhe të të folmeve të gegërishtes. Ndryshimet në temë përkojnë gjithashtu me tendencën e përgjithshme të reduktimit e të thjeshtimit të strukturës fonetike të paskajores.

Po t'i hedhim një vështrim shumë të përgjithshëm gjendjes së sotme të këtyre të folmeve, pavarësisht nga disa veçori që ka secila prej tyre, konstatojmë që kjo tendencë e përgjithshme është ende aktive dhe si pasojë e këtij fakti struktura fonetike e infinitivit gegë sot paraqitet mjaft e rrëgjuar.⁴² Prandaj, duke pasur parasysh sa diskutuam deri tani, mund të themi se gjatë periudhës së shkruar të shqipes paskajorja në dialektin gegë na del me dy trajta: atë më të hershmen që mund ta quajmë edhe *trajtë të plotë* dhe atë më të vonë, që mund ta quajmë edhe *trajtë të shkurtuar*, sepse në krahasim me të parën ajo është më e reduktuar.

Më së fundi do të thonim që ndryshimet e shumta që ka pësuar struktura formale e paskajores gege gjatë këtyre pesë shekujve lidhen edhe me çështjen shumë të diskutuar të vjetërsisë së saj në këtë gjuhë. Sigurisht, vetëm ana formale nuk mjafton për të dhënë një përgjigje përfundimtare në këtë pikë, por mendojmë që nuk mund të mos merret fare parasysh. Kështu, në mënyrë të përgjithshme mund të thuhet se nëse paskajorja gege do të ishte me të vërtetë shumë e vjetër, sikurse edhe është pretenduar shpesh, atëherë do të pritnim që ajo të përdorej që në fillim në dokumentet e shkruara *jo me trajtën e plotë, por me trajtën e shkurtuar të saj*, ose të paktën me një trajtë më të reduktuar. Ndryshimi shumë i madh në planin formal që ka pësuar paskajorja që nga

⁴¹ Shih më lart shënimet nr. 21 dhe 23, si dhe në f. 6 shembujt e mëposhtëm: e ai ju ka për të ju *dëftyam* vend të madh (A. i Elbasanit, 72) - kam *me shkâum* me vërtetëni tate (Dh. Todhri, 176) - kam *me lavdumun* emënit tat më jetët (176) - mos ki *me largumun* mallëngjimin tat prej nesh (176) - qi të ket *me i mallëngjymun* zoti (168). Lidhur me kohën kur duhet të ketë filluar ky proces E. Çabej, *vep. cit.*, vëll. VI, Prishtinë, 1977, f. 123 thotë: "Reth 1710-s në gegërishten kishte hyrë nëpër krahina monoftongimi, sepse në fjalorthin gegërisht të vitit 1710 që gjindet dorëshkrim në abacinë e bazilianëve në Grottaferrata pranë Romës, fjalorth i datuar prej Durrësi në atë vit... këndojmë Abbreviare Me schurtuum, ku u-ja shkruar dyfish do të shënojë zanoren e gjatë, përbri Fine Të mbaruemit.

⁴² Shih më hollësisht për këtë artikujt përkatës në serinë *Dialektologjia Shqiptare*, I, Tiranë 1971, II, Tiranë, 1974, III, Tiranë 1975, IV, Tiranë, 1982 dhe V, Tiranë, 1987.

vepra e Buzukut e deri më sot është sipas mendimit tonë një e dhënë që flet në përgjithësi kundër vjetërsisë së saj.

Përveç kësaj, evolucioni formal që ka pësuar paskajorja shqipe gjatë këtij harku kohor lidhet edhe me frekuencën e përdorimit të saj në këtë gjuhë. Ai tregon se me gjithë konkurrencën e vazhdueshme të fjalive të varura me lidhore ose me forma të tjera të pashtjelluara, frekuenca e përdorimit të saj ka ardhur vazhdimisht duke u shtuar dhe jo duke u zvogëluar, gjë që ka qenë pa dyshim edhe njëri prej shkaqeve kryesore që kanë çuar në rrafshimin fonetik të saj⁴³. Pra, ai dëshmon për jetën e saj shumë të gjallë në gjuhë në kushtet kur mundësia e një ndikimi nga jashtë vështirë se mund të diskutohet.

A. LITERATURA BURIMORE

I. Autorët e vjetër (Mesi i shek. XVI – Fundi i shek. XVII)

Gjon Buzuku: Eqrem Çabej. 1968. “*Meshari*” i Gjon Buzukut (1555). Botim kritik. Pjesa e dytë: Faksimile dhe transkribim fonetik. Tiranë.

Pjetër Budi: Gunnar Svane. 1985. *Pjetër Budi. Dottrina Christiana (1618)*. Århus. Cit.: DC.

Frang Bardhi: Bardhyl Demiraj. 2008. *Dictionarium latino epiroticum*. Shkodër. (Faksimile e origjinalit, Romë 1635).

Pjetër Bogdani: Anila Omari. 2005. *Cuneus Prophetarum (Çeta e Profetëve)*. Tiranë. (Faksimile e origjinalit, Padua 1685).

Gjon Kazazi: Bardhyl Demiraj. 2006. Gjon P. Kazazi dhe Doktrina e tij. Prishtinë. Cit.: BC

II. Vepra dhe botime të dorëshkrimeve origjinale (prej mesit të shek. XVIII)

⁴³ Në studimin tonë *Variantet fonetike dhe funksionet sintaksore të paskajores geqe te “Epika legjendare e Rugovës”*, “Eposi i Kreshnikëve: Monument i trashëgimisë kulturore shqiptare”, Prishtinë 2016, f. 591-592, arrijmë në përfundimin se “Vihet re mbizotërimi i paskajores kundrejt lidhores dhe formave të pashtjelluara. Krahas dëftores ajo është mënyra kryesore foljore që njohin këto të folme. Prandaj shpesh, kur vijnë disa fjali të varura njëra pas tjetrës, krijohen vargje të tëra me paskajore... Duke vazhduar krahasimin me letërsinë e vjetër shqipe vihet re shtimi i frekuencës së përdorimit të paskajores së pavarur dhe zgjerimi i gamës kuptimore të saj me nuancat e përmenduar më lart, me përjashtim të paskajores dëshirore. Nuk mund të përcaktohet përfundimisht se cilën fazë të zhvillimit historik të gegërishtes përfaqësojnë këto të folme, por krahasimi me Bogdanin mbështet mendimin se paskajorja ka fituar shumë terren në kurriz të lidhores”.

- Anonimi i Elbasanit: Injac Zamputi. *Dorëshkrimi i Anonimit t'Elbasanit - transliterim, transkriptim dhe koment* në "Buletin i Institutit të Shkencave", 1951, nr. 3 - 4, f. 64-131.
- Dh. S. Shuteriqi. *Shkrime të Dhaskal Todhërit dhe të pasardhësve të tij elbasanas, shoqëruar me fjalorin e shkrimeve të Todhërit* në "Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore", 1959, nr. 1, f. 165-197.
- Djali Plangprishës: Idriz Ajeti. 1978. *Kërkime gjuhësore*. Prishtinë, f. 218-234. Ai sjell këtu përkthimin e parabolës së "Djalit të humbur" në të folmen gege të Istrias regjistruar nga G. Corinaldi në vitin 1835. Ky dorëshkrim që mban datën 20 shtator 1835 u botua për herë të parë nga Matteo Bartoli te *Studi albanesi*, I, Roma 1931.
- Zef Guagliata. 1856. *Dottrina e Kershten Cardinallit Bellarmino t'Shoqniët Jesus khiellun n'shqyp prej P. Zefit Guagliata t'shoqniët Evet*, N'Rom të shtampuemin t'shehit Kuven De Propaganda Fide. Rom. Ribotim [Botimi i parë në vitin 1845].
- Karl Reinhold. 2005. *Netët Pellazgjike të Karl Reinholdit. Tekste të vjetra shqipe të Greqisë mbledhur nga KARL REINHOLD 1850 - 1860 transkriptuar e shpjeguar nga ARDIAN KLOSI*. Tiranë.
- Giuseppe Jubany. 1871. *Raccolta di canti popolari e rapsodie di poemi albanesi*. Trieste.
- Konstantin Kristoforidhi. 1872. *Kater ungilat' e zotit e Ëe šelbuesit t'une Iesu-Krištit, e Ëe punet' e apoštuyvet, kehuem prej grekištese vieter škip nde guhe gegenište prej Konstantinit Kristoforidit, Elbasanasit*. Konstantinopol.
- P. Leonardo De-Martino. 1881. *L'arpa d'un italo-albanese*. Venecia.
- Hil Mosi. 1913. *Zân' i atdheut. Vjersha atdhetare*. Shtypëshkroja Dolenc. Trieshtë.

B. BIBLIOGRAFI

- Arap, I. (2010), *Der Gebrauch von Infinitiv und Konjunktiv im Altalbanischen mit Ausblick auf das Rumänische* (Përdorimi i paskajores dhe lidhoren në shqipen e vjetër në krahasim me rumanishten). Hamburg.
- Arap, I. (2016), *Variantet fonetike dhe funksionet sintaksore të paskajores gege te "Epika legjendare e Rugovës"* në "Eposi i Kreshnikëve: Monument i trashëgimisë kulturore shqiptare", vëllimi II, Konferencë Shkencore Ndërkombëtare, Prishtinë, 28-30 gusht 2010, Prishtinë, f. 567-594.
- Bacinschi, I. (1946), *L'infinitif et les moyens de son remplacement. Étude de syntaxe historique et comparée*. Bucarest. Imprimerie "Bucovina" I. E. Torouțiu.

- Çabej, E. (1977), *Diftongje e grupe zanoresh* në “Studime gjuhësore VI” (marrë nga Buletini i USHT, Seria shkencat shoqërore, 1958, nr. 3, Tiranë). Prishtinë, f. 117-136.
- Çabej, E. (1976), *Studime gjuhësore III*. Prishtinë.
- Demiraj, Sh. (1986), *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Gramatika e gjuhës shqipe. Vëllimi I. Morfologjia*. 2002. Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë.
- Ismajli, R. (1982), *Gramatika e parë e gjuhës shqipe*. Botim kritik, me studim e transkriptim. Prishtinë. Shtëpia Botuese “Rilindja”.
- Kodra, Z. (1952), *Letërsia e vjetër shqipe dhe arbëreshe*. Tiranë.
- Koperaj, E. 2014, *Format e pashtjelluara në shqipen e dokumentuar të shekujve XVI-XVIII*, disertacion doktrate, dorëshkrim. (Falenderoj prof. Anila Omarin që më vuri në dijeni për ekzistencën e këtij punimi)
- Lafe, E. (1965), *Trajtat e pjesores te Gjon Buzuku* në “Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 15-21 nëntor 1962”. Tiranë.
- Mansaku, S., *Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj* në “Studime filologjike”, 1982/1, Tiranë, f. 139-162.
- Mulaku, L. (1968), *Govor Albanaca Bajgorske Šaljje*. Prishtinë.
- Mulaku, R. (1987), *Sistemi foljor në gjuhën e shkrimtarëve të vjetër veriorë*. Prishtinë.
- Paço, E. *Pjesorja në veprën e P. Bogdanit* në “Studime filologjike”, 1981/3, Tiranë, f. 75-86.
- Pekmezi, Gj. (1908), *Grammatik der albanesischen Sprache*. Wien.
- Shuteriqi, Dh. S. (1955), *Histori e letërsisë shqipe për shkollat e mesme*. Tiranë.
- Xanoni, A. M. (1909), *Gramatika shqyp*. Shkodër.

SUMMARY

PHONETIC FORMS AND GRAMMATICAL CATEGORIES OF THE INFINITIVE IN ALBANIAN LANGUAGE

This article analyzes the evolution of the phonetic structure and grammatical categories of the infinitive in the Albanian language. When we speak about the infinitive in Albanian, we always keep in mind the infinite analytical verbal form of the type *me + participle*, which is used in the Gheg dialect with the syntactic functions that are characteristic for the infinitive of the i.e. languages. In a synchronous plane, the infinitive of the type *me + participle* is interpreted as consisting of the particle *me* “with” and the participle. The particle *me* is of prepositional origin, but has long lost its

functions as preposition and has been completely desemantized, while the second element fully corresponds to the participle, which is a fact widely accepted in all descriptive grammars of the Albanian language. In the diachronic plane, this participle is sometimes considered as participle, sometimes as a substantiate participle and sometimes as infinitive, but the most grounded opinion seems to be the assumption that here, we are at its origins dealing with a substantiate participle without an article of type *pasë -a* “having”, *lypë -a* “begging” etc. Under these conditions we must admit that the infinitive of type *me* +participle was formed as such during the historical evolution, together with the particle *me*, which is proved by the fact that the particle *me* at the Gheg infinitive is necessary and cannot be absent, as for example in German or Romanian. So the particle *me* has become an indispensable morpheme for the infinitive, just like the morpheme *të* for the subjunctive mood. Since the first written document (1555) the Gheg infinitive has undergone significant phonetic changes, which relate to the participle and not to the particle *me*, which has remained unchanged throughout this time.

The paper is divided into two parts. The first section presents the phonetic evolution of the infinitive, that is, the Gheg participle, dividing it into two historical periods. The first period includes the works of the old Gheg writers who were written from the middle of the 16th century to the middle of the 18th century (Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Kuvendi i Arbënit, Gjon Kazazi), while the second period includes works written by the second half of the 18th century until 1872. The main feature of the phonetic structure of the infinitive during the first period is that it comes out with a suffix regularly. The suffixes with which the participle is formed, respectively the infinitives are: *-m*, *-në*, *-un(ë)*, *-ë* and *-të*. On the basis of the very detailed excerpts she has made, the author points out the first cases of the suffixes being dropped and mixed up. In the second period (The Anonymous of Elbasan, Dhaskal Todhri, Zef Guagliata, Zef Jubani, Konstantin Kristoforidhi) the tendency of losing the suffixes in the participle and infinitive, as well as that of their mixing, is increasing. The later authors tend to sporadically preserve the suffixes. In conclusion, we can say that during the literary period, beginning in the middle of the 16th century the participle and respectively the infinitive in the Gheg dialect has two forms: an earlier form we can also call the full form and a later one we might also call it the abbreviated form. The numerous phonetic changes that the Gheg participle / infinitive have undergone may be an indicator of its relatively young age. On the other hand, these changes are also related to the frequency of its use in this dialect, which has been increasing and which has undoubtedly been one of the main causes that have led to its phonetic leveling.

In the second part of the paper, we analyze the grammatical categories of the Gheg infinitive, i. e. the grammatical category of diathesis and that of time. Diathesis is the only grammatical category of the infinitive, clearly distinguished since the first written document of Albanian. The diathesis is constructed by the particle *u* of pronominal origin placed between the particle *me* and the participle or with the auxiliary verb *jam* “to be”. For example: *Natyra e këtyne qiellje âshtë gjithëherë me u luejtune* “la natura di questi Cieli è di sempre muoverci” (Bogdani I, 25); *ashtu, sikundrëse meriton me qenë paguom puna e tyre* “just as their work deserves to be paid” (Budi, *Dottrina Christiana*, 127). There are no functional differences between these two forms. In the semantic plane, the forms with *u* denote the action simply as being any process, those with the verb *jam* denote the action more as a result of a process, so they emphasize the resultant aspect. Regarding the grammatical category of the time, as in most languages that have an infinitive, in Albanian also, there are formally two forms of it: present and past. The present infinitive, as we have mentioned at the outset, is formed by the particle *me* with the participle of the conjugated verb, for instance *me punue* “to work”, while the past infinitive from the infinitive of the auxiliary verb *kam* “to have” and the participle of the conjugated verb, i. e. *me pasë punue* “to have worked”. In terms of the temporal meanings expressed by the present infinitive we must first distinguish the so called independent from the dependent infinitive. The independent infinitive is usually used with the temporal meaning of the present, while the dependent infinitive has a temporal meaning conditioned by the temporal meaning of the directional verb. The passive form of the infinitive is constructed by the pronominal particle *u* placed between the particle *me* and the participle. While analyzing the use of the past infinitive by the old Albanian writers, the author concludes that the past infinitive is actually used by them in the temporal sense of the future. Consequently, it can be said that the grammatical category of time by the Albanian infinitive has fictitious and not real value.